

BIBLIOTEKA
SHTETIT

884-32
263

MIHALLAQ QILLERI



TREGIME

JETA MBI
SHKEMBINJ

8JH-52

263

MIHALLAQ QILLERI

JETA MBI SHKËMBIJN

tregime



SHTËPIA BOTUËSE • NAIM FRASHERI •

NJERIU ME SHARK

Kur më së fundi çadra e gjelbër u shkul nga vendi, nën dyshemenë e saj mbeti një katrор bari i zverdhur, anemik, me kércej thuajse të bardhë. Rreth këtij katrорi jeshilonin akoma tërfili i malit, hithratë njoma e gjembaçë të kaltër. Kolonat e gëershërezave, që deri në atë kohë i kishin shpëtuar vapës, të fshehura nën mushamanë e dyshemesë së çadrës, nxituan të zinin hije të tjera, nën gjelbërimin e harlisur të Qafës së Lekës. Nga fillimi i majit nuk kishte mbetur më asgjë, përveç atij katrорi me kércej anemikë të asaj toke të tharë e të plasaritur që u kishte shpëtuar stuhive të pranverës, nën mburojën e gomuar. Tomi ishte ulur mbi njërin nga thasët ku ishin futur dyshekët dhe po shfletonte një blok dokumentimesh. Unë lidha fort thesin tjetër dhe u nisa për nga kreshta mbi qafë, për të parë në duke-shin mushkat. Një pjesë të pajisjeve tona fushore i kishin nisur nga dy orë më parë në drejtëm të Shter-pasit.

Fundi i shtatorit atë vit qëlloi gjithë lagështirë. Erë frynte shumë dhe çadra jonë do të kishte flutruar, në qoftë se nuk do ta kishim forcuar qysh më parë me gurë. U ula në tokë dhe shtriva shikimin përgjatë kurrizit të zhveshur të malit. Rruga e kaf-

shëve aty ngjitej e pak më tej zbriste me ca zigzage, dhe nën këmbët e mia fshihej në grykën e një pérroi. Diku, në një majë tjetër të po atij vargmalë, Tomi më pat treguar dikur një kasolle të vëtmuar. Atë ditë nuk kishte mjegull dhe unë e dalloja qartë shtrungën e bagëtive, të ndërtuar me gurë të bardhë dhe kazanët e llamarintë të qumështit, varur në një pemë, që shkëlqenin nga dielli...

Mushkat u dukën së largu. U ktheva te Tomi dhe së bashku u dhamë dorën e fundit ngarkesave. I pari e kapërceu qafën Dani dhe, duke tundur anash këmbët e mbështetura pas shkallëzave prej litari, lajmëronte me të thirrura mbërritjen e kafshëve. U hodh nga mushka para nesh dhe, duke iu drejtuar Tomit, thirri:

— Një vend i mrekullueshëm, inxhinier! Për kokën time, në kam pirë ujë më të ftohtë. Gjetëm belanë me një lukuni qensh. E beson, njëri ishte sa një viç.

Tomi ngriti kokën dhe i buzëqeshi.

— Ju dhanë gjësendi çobanët?

— Kos, një kos të mrekullueshëm, që ta pritje me thikë.

— Ejani tani të ngarkojmë, — thashë unë. — Të paktën ta ngremë përsëri çadrën sa pa rënë nata.

Gjysmë ore më vonë ne ishim në rrugë. Mushkat capiteshin të lodhura. Në pjerrësinë e malit frynte një erë e ngrohtë që premtonte kohë të mirë. Aty-këtu lulëzonin akoma filizat e dytë të çajit, të shkurtër e gjithë lule.

Në Shterpas arritëm rreth orës katër. Na kishte marrë uria, megjithatë askush nga ne nuk u ul të hante pa mbaruar më parë së ngrituri çadrën. Një qen i madh, i zi, me pulla të bardhë mbi veshët e

gjatë, kishte qëndruar ndonja dhjetë metra larg nesh
dhe na vështronte me sy të egërsuar.

Sa shtruam krevatet, Tomi ndezi kamineton. Pritja të shikoja mbi zjarr ndonjë tenxhere, por, për habinë time, vura re se ai po ngrohte bateritë e transistorit. Pas pak ushtoi nga aparati një melodji baritore dhe menjëherë pas kësaj tufa e qenve filloj të cirrej e të ulërinte rrëth e rrrotull çadrës. Qeshëm me të madhe. Dani fiku radion. Qentë pushuan së lehuri. Ai e ndezi përsëri dhe befas ndjeva se çadra gati sa nuk shembej. Urdhërova Danin ta fikte menjëherë transistorin. Të lehurat u rralluan ngadalë dhe menjëherë, pasi kishin pushuar, një zë i fortë burri thirri nga jashtë:

— A pritni miq, o gjeologë?

Nxitova të hapja hyrjen e çadrës. Para meje u shfaq një burrë truplartë, i mbështjellë me shark të zi. Kishte një fytyrë të gjatë me mollëza të kërcyera dhe, i rruar taze siç ishte, nën lëkurën e hollë të fytyrës i dalloheshin kapilarët e kuq gjithë gjak.

— Mirëmbrëma! — përshëndeti ai dhe, duke përkulur trupin, u fut brenda në çadër.

U takua me të gjithë. U ul në një cep të krevatit të Tomit dhe shtriu me dorë mustaqet e verdha. I zgjata paqetën e cigareve. Ne biseduam pak, fare pak atë mbasdite, sepse ai nxiton. Ditët e fundit kishte mbetur i vetëm, sepse shokët kishin shkuar në fshat për një mbledhje të kooperativës. Na premtoi se qenin e zi do ta lidhte që atë natë, kështu që të mos kishim frikë kur të dilnim nga çadra. U ngrit dhe doli. Pas pak u kthyje përsëri me një tenxhere plot me qumësht.

Ky ishte takimi ynë i parë me këtë njeri.

Një javë më vonë koha u keqësua shumë. Puna

na u vështirësua. Dy a tri pika të mineralizuara që kishim hapur aty nga fillimi i sezonit, kishin dalë aq të varfra në përmbajtje, sa as që ia vlente të flitej për to. Dhe tani zona e zhveshur e Shterpasit nuk po na sillte asgjë të re. Kanali i fundit kishte arri-
tur një thellësi të rrezikshme. Thellonim atë tokë të fortë, pa dalluar asgjë nga ajo që na interesonte. Shpesh na dukej se ja, diku pas asaj shtresëze të murme diçka do të shpérthente së fundi. Këtë padurim nuk mund ta kenë provuar shumë njerëz. Tomi dhe unë i ndamë itineraret e marshrutave. Megjithatë, kur ktheheshim mbasdite në çadër, të etur dhe të uritur, diskutimet tona të pafundme mbete-
shin në një pikë: Ky vargmal nuk vlente për asgjë.

Në një nga këto ditë, aty nga ora dhjetë e mën-
gjesit; filloi të vesonte. Shiu binte ngadalë, i rrallë,
thuajse me dembelizëm. Mjegulla ishte bërë më e tejdrukshme, po më e ftohtë. Këtë e ndieja nga duart që më ngrinin, në brymën e argjendtë që kishte lënë mjegulla në flokët e Tomit, i cili ishte futur në kanal dhe gërmonte së bashku me punëtorët. Unë isha ulur mbi dheun e trashë që kishte dalë nga kanali dhe po mundohesha të orientoja hartën për
të hedhur në të atë punim.

Papritur një siluetë e murme u shfaq midis mjegullës. Ajo mbiu para meje aq befasisht, sa, për një çast nuk u besova syve. Prania e një njeriu në atë vend ku kishim përqëndruar të gjitha shqetësimet tona, ishte thuajse si një rreze e ngrohtë që shpërndan mjegullën. Disa sekonda më vonë dallova të afrohej drejt meje çobani me shark. Mbi kokë kishte hedhur një llabane të punuar me lesh dhish. Mbi fijet e gjata të sharkut ndritnin pikëza mjegulle, që zhvendosej më një anë dhe rrrotullohej rreth tij si

vorbull. Llabanen e kishte ulur aq tepér në fytyrë, sa, pérveç mustaqeve dhe mjekrës mäsive e të parruar, nuk mund t'i dalloje asgjë tjetër.

U ngrita më këmbë. Ai më tha «mirëmëngjesi», qëndroi një copë herë në buzë të kanalit dhe vështroi ata që gérmonin.

— Puna mbarë! — uroi ai me zë të lartë,

Ata që ishin brenda, drejtuan shpinat dhe i buzqeshën. Njeriu me shark shtyu llabanen në kurriz. Tani ai doli para meje thuajse me një fytyrë tjetër. Sytë i shkëlqenin aq tepér, sa m'u krijua përshtypja se të vetmen kaltërsi atë ditë me mjegull mund ta gjeje nën vetullat e tij të trasha e të zeza. Befas qimbështolli sharkun dhe unë dallova të nxirrte nga pas kurrizit, si një prestigjator i shkathët, një kërrabë të shkurtër. Nguli njérën anë të saj në tokë dhe u mbështet mbi të.

— Përse gérmoni këtu? — pyeti ai, duke m'u drejtuar mua. Siç duket mendonte se unë isha kryesori në këtë punë, meqë në vend që të gérmoja, si të tjerët, po merresha me letrat që kisha në dorë.

— Kërkojmë mineral, — iu përgjigja.

— Pse, kështu e kérkon? Nuk keni aparate?

— Jo, kërkojmë me sy.

— E çuditshme..., — murmuriti ai, — me sy? Po kështu mund ta gérmoni gjithë malin dhe të mos gjeni asgjë!

Tomi hodhi kazmën më një anë dhe doli nga kanali. Fshiu duart pas pantallonave dhe i zgjati paqetën e cigareve. Pastaj ma hodhi fluturimthi edhe mua.

— Nuk e di përse nuk na keni dalë fare, — tha pastaj. — Në këto male vijnë shumë rrallë njerëz dhe të mirët ne i presim si miq të vërtetë.

— Ke tē drejtë, — iu përgjigj Tomi. — Por, si tē ta them... këtu nuk para na ka ecur puna mbarë dhe lodhemi e këputemi aq shumë gjithë ditën, sa ia marrim që shpejt më gjumë.

Mbrëmë do tē vija përsëri te ju, — tha njeriu me shark, — por, kur u vumë tē numëronim bagëtinë, pamë se na mungonin dy kokë. Ishin dy pëlla. Me siguri i ka çarë bisha. Kam gjithë ratën dhe sot gjysmën e ditës që po i kërkoj. Të paktën t'u gjej shenjën.

Në fytyrën e tij tē madhe ra një hije trishtimi. Si pér ta fshehur këtë hije, mbuloi sytë me llabane. Tomi e pa drejt në sy. Unë ula kokën. M'u dhimbë. Endieja fatkeqësinë e tij aq shumë, sa, sikur tē kisha mundësi, do tē shkoja së bashku me tē pér t'i gjetur ato dy dele.

— Duhet tē kishit ardhur, — tha befas përsëri ai.

— Nuk na ka nxjerrë rruga, — nxitova tē thosha unë diçka më tē mirë se Tomi.

— Malet nuk kanë rrugë, — m'u përgjigj aty pér aty, — megjithatë majat lidhen me njëra-tjetren.

Ai kishte tē drejtë.

E gjithë zona ku zhvillonim punime, nga Qafa e Lekës e deri në Shterpas, ishte aq e thepisur dhe e zhveshur, sa çobanët nuk kishin pse ta sillnin bagëtinë në ato anë. Aty bagëtia mund tē rrëzohej dhe tē bëhej ushqim pér bishat. Shkurt, ne vërtet na bashkonin malet, por po ato na ndanin. Megjithatë ky çoban më ofronte një ndjenjë mirënjojheje që lind pér njerëzit, kur masivet gri tē maleve tē imponojnë vetminë e tyre. Kësaj nuk ke si i shpëton. Këtë ndjenjë e kisha provuar edhe një herë tjetër, një mbrëmje aty nga fundi i gushtit, kur diku në majën më tē lartë tē atij vargmali kisha dalluar një

hije njeriu. Ia tregova Tomit, dhe të dy së bashku filluam të fantazonim. As që e kuptonim se ç'mund të kërkonte ky njeri aq larg e lart. Pas shumë haminjesh Tomi tha se i panjohuri mund të ishte çoban që kishte shkuar atje pér të kërkuar dëborë nëpër gropë. Ky mendim u dha fund debateve tonë. Hinen e errët të njeriut që kishte zbritur nga maja, e kishte përpirë nata. M'u kujtua legjenda e «Njeriut të dëborës» që kisha lexuar dikur në një gazetë dhe qesha. Tomit, ashtu si edhe mua, me siguri i vinte keq që ai njeri ishte larguar nga çadra jonë e gjelbër, të cilën duhej ta kishte parë me siguri. Ky pat qenë takimi i parë me njerëzit në ato anë.

Çobani që kishim tanë afër, ishte i dyti. Ai vazhdonte të thithë me etje cigaren dhe mendohej. Ishin ulur edhe punëtorët. Një çast i hodhi tej, siç duket, ato mendimet e tij pér delet e zhdukura dhe pyeti:

— Po mirë, ç'kërkoni, xhanëm?

Tomi i tha emrin e mineralit. Përsëri nisi të na pyeste. Interesohej se ku përdorej më shumë, si e gjenim ne gjeologët dhe së fundi na u lut t'i tregcnim një copë prej tij.

Nxora nga xhepi një kampion fâre të vogël dhe ia dhashë në dorë. Ai ngriti vetullat çark, e pështyu, sikur të donte ta shpëlante pér ta dalluar më mirë dhe na e ktheu përsëri duke buzëqeshur.

— Pér këtë... pér këtë gur mundoheni kaq shumë?! — tha befas aq mospërfillës, sa unë e ndjeva veten gati të fyter. Edhe Tomi, edhe punëtorët e vështruan të çuditur. I mbërtheva sytë në fytyrë dhe pritja të na thoshte se kishte bërë shaka.

— Po..., — iu përgjegja, — pér këtë!

— Nga ky ka sa të duash, — ma ktheu.

Unë dhe Tomi vështruam njëri-tjetrin. Mendja

më vajti mënjetërë tek ato dy pikat të mineralizuara që kishim kapur gjatë atij sezonit. Çobani duhej t'i kishte hasur diku dhe t'i kishte rënë rasti t'i shikonte me vëmendje. Dhe sa mirë që i kishte njohur! Megjithatë edhe ky fakt më habiti.

— Ku? — e pyeta me padurim.

— Këtej, — tha ai dhe zgjati dorën drejt lindjes.

E vështrova me mosbesim. Shiu vazhdonte të binte ngadalë, i hollë, i ftohtë. Mjegulla po ngrivej lehtë e zbulonte njërin pas tjetrit kurrizet e përthyera të maleve që binin diku larg në horizont. Pas mjegullës kishte diell.

Tomi vështroi përsëri nga unë. Në sytë e tij dallohej qartë një kureshtje thuajse e paduruar. Në atë vështrim pasqyrohej lëvizja gjithë nervozizëm e mjegullës. Mbështeti mjekrën pas kupës së gjurit dhe i foli njeriut me shark me zë të ulët:

— A mund të na e tregosh atë vend?

— Me gjithë qejf — tha ai. — Andej kam ndër mend të shkoj edhe unë. Është foleja e bishave. Të vetmen shpresë, ku kam ndër mend t'u gjej ndoca fije leshi deleve të mia, e kam tek ato humnera.

Unë dhe Tomi, sikur të ishim në një mendje, nuk e shtymë më tej mosbesimin tonë. Ai njeri, nuk e di përsë, më bëri përvete. Në fjalët e tij kishte diçka sa të ashpër, aq edhe të butë. Nën hijen e dendur të qepallave i pashë sytë e kaltër t'i qeshnin. Një tufë flokësh të thinjur i ishte shkëputur nga nënllabania dhe i godiste vetullën e djathitë. E kuptova. Ai na ftonte të bënim që atë çast atë rrugë të vështirë, paçka se shiu nuk kishte ndër mend të pushonte. U ngrita më këmbë. Pas meje u ngrit edhe Tomi. U dhamë punëtorëve ca udhëzime shpejt e shpejt dhe u nisëm.

Ai ecte përpara. Tomi pas meje. Nuk mund të them se i njihja pak malet, po shkathtësia e ecjes së tij më habiste. Këmbët i hidhte të sigurta edhe në gurët që lëviznin, sikur ta dinte qysh më parë këtë. Kishte një hap të gjatë, të ngadalshëm, të ngjeshur. Sharku i zi i godiste këmbët e veshura me shajak, dhe mua më vinte habi se si nuk i rëndonte në gjithë atë të përpjetë.

Udhëtuam kështu afro një orë. Pas një qafe të ngushtë hapej një hapësirë e gjerë malore me gropatë mëdha karstike, të mbushura me vegjetacion. Midis këtyre lloj fushëzave të rrumbullakëta ngriheshin togje shkëmbinjsh të shtresëzuar. Befas, pas kësaj butësie malore, u hap para syve tanë një e çarë, vigane për nga përpjesëtimet, e frikshme për nga greminat. Ajo kishte veçuar malet nga njëri-tjetri me të gjithë ashpërsinë që karakterizon lëvizjet e mëdha tektonike dhe humbiste po aq madhështore diku, tutje nga veriu. Poshtë, shumë poshë mezi dallohej zalli i bardhë i një përrroi të ngushtë. Ndalëm në majë të një shkëmbi. Njeriu me shark tregoi me gishtin e trashë drejt greminës dhe tha me ngadalë:

— Këtu!

Ngrita kokën ta vështroja në fytyrë. Kështu bëri edhe Tomi. Tallej me ne, vallë? Atë hon të lemëri shëm nuk mund ta kishin parë veçse zogjtë. Mbi shtresëzimet masive, të rrudhosura çuditërisht tepër, kishin mbirë aty-këtu rrënë drurësh të shkurtër dhe fije të rralla bari. Asgjë tjetër nuk të shikonte syri në ato mure fantastike.

— Si mund të kesh parë këtu?! — murmuriti Tomi, i habitur.

— E kam parë në përrua, — u përgjigj aty për

aty. — Kam parë me qindra copa si ai që më treguat. Me mijëra...

— Po përroi nuk fillon këtu, — i kundërshtova unë.

— Përrenjtë mbushen nga malet! — tha ashpër ai. — Në mos këtu, atje më tej. Sidoqoftë nga ky mineral ka.

Këto fjalë më fshikëlluan keq. Ai çoban, dashur pa dashur, po më kujtonte me aq thjeshtësi dhe besimi në vetvete, abecenë e gjeologjisë.

U ulëm. Ai ndenji këmbëkryq mbi shkëmb, thuhaje qe ulur mbi një shilte të butë. Ndezëm nga një cigare. Tashmë para greminës, këmbëkryq në buzë të saj, më dukej sikur këtë njeri e njihja prej kohësh dhe megjithatë nuk e di se çfarë ma bënte po aq të panjohur. Ra një rreze dielli. Mjegulla po grumbullonej majës më të lartë, atje ku ne kishim parë dikur «njeriun e dëborës». Ajo rreze dielli e bëri mjegullën çuditërisht më të tejdukshme dhe tani maja e lartë dukej si fundi i qiellit. Më vështroi drejt në sy. Siç dukej kërkonte të mësonte se çfarë bluaja. Tomi na kishte kthyer kurrizin. Nuk e kisha mendjen më te maja fantastike. Nga kjo lartësi, disa sekonda më parë, kisha zbritur me mend në humnerën e thellë që dukej si fundi i tokës. Ishte e pamundur të besoja se ai njeri kishte qenë ndonjëherë atje. Sado që i lodha sytë, nuk dallova gjëkundi ndonjë shteg për të zbritur në hon. Hapa hartën topografike dhe u mundova të lexoja gjësendi atje. Por jo. Vijat rrushkulluese në atë vend ishin zëvendësuar me ca hieroglife të imta që do të thoshin se aty gjithkund kishte rrëzime vigane.

— Unë do të zbres! — tha befas ai, sikur ta kishte kuptuar se ne na kishte pushtuar pështjellimi.

— Siç duket, delet e mia vlejnë më shumë se minerali juaj. — Nxori nga xhepi një sahat të madh me zinxhir të bardhë dhe, si i hapi kapakun, shtoi:
— Ora është dyimbëdhjetë. Për dy orë jemi në fund, hë, ç'thoni?

Tomi luajti nga vendi dhe u ngrit më këmbë. Më vështroi pjerrtas. Në shikimin e tij kishte edhe guxim, edhe frikë. Buzëqesha zbetë. Në fakt, nuk e di përse, pritja nga çasti në çast që njeriu me shark të fillonte të qeshte më së fundi dhe të na thoshte se deri atëherë kishte bërë vetëm shaka dhe tanj donte të na provonte se sa na viente lëkura.

— A je i sigurt se janë po këto copa? — dhe nxora nga xhepi kampionin e vogël që ta shikonte edhe një herë.

— Po, — tha ai, — shumë i sigurt. Ne çobanët i njobhim gurët siç njobhim bagëtinë. Por, ndryshe nga ju, ne nuk e dimë se ç'janë dhe për se vlejnë.

Si tha këto, u ngrit edhe ai më këmbë. Në fyttyrën e tij reflektohej ajo butësia shpirtërore për atë që do t'i takonte të bënte pas pak, sa me të vërtetë e bënte të madhërishëm. I hodhi një vështrim mos-përfillës greminës dhe qeshi.

— Për dy orë, — tha ai, — mundet edhe më shpejt!

Qeshi edhe Tomi. Pastaj na pushtoi një gjëzim i papritur të tre. Dhe e ndoqëm pas me besimin se ai njeri, që kishte zbritur e ngjitur në të tillë gremina, nuk mund të gabonte lehtë.

KUR MË ERDHI RADHA TË FLITJA

Ne dikur ishim shokë të ngushtë, por, megjithatë, kohët e fundit nuk doja ta mbaja më këtë miqësi si një stoli të thjeshtë. E doja Ramon më shumë se të gjithë tjerët dhe më takonte po mua ta mbroja. Ditë me radhë ai ishte si në ethe. Kishte filluar të punonte më shumë, por, për çudi, kjo punë e tij më dukej bajate, si jo më gjithë zemër. Nuk e di përsë e mendoja kështu, po kam përshtypjen se puna e mirë nuk i honeps llafet e shumta. Ramoja hynte e dilte nëpër galeritë tona, na pyeste në kishim ndonjë nevojë të ngutshme dhe, pasi i shënonte kérkesat në një bllok të vogël xhepi, largohej nga fronti me dorën në hundë dhe në gojë, për t'u mbrojtur nga pluhuri i birave. Ky gjest më dukej si shumë i llastuar, veçanërisht mua, që e njihja Ramon qysh fëmijë.

Ishim të dy nga një fshat. Bashkë kishim kullotur bagëtinë, kishim luajtur në të njëjtat hije dhe po bashkë u rritëm. Unë mbarova shtatëvjeçaren dhe e lashë shkollën me aq. Ai vazhdoi edhe tri të mësme. Po se ku mbeti në dy a tri lëndë dhe u kthyesh përsëri në fshat. Mbaj mend se ca muaj u sorollat poshtë e lart, pastaj u fut në bujqësi. Dangadalë, ai nisi të punonte baras me shokët. Së an-

dejmi erdhëm këtu, në gjeologji, u futëm në galeri, po pas dy muajsh Ramoja na u bë magazinier. Natyrisht unë gëzova atëherë, po nuk e dija se sa shumë do të pendohesha më vonë...

Të gjitha këto më kujtoheshin tek dëgjoja shokët të flitnin në mbledhje aq ashpër për Ramon dhe të kërkonin që ai ta dorëzonte magazinën dhe të fillonte punën përsëri në galeri. Ai ishte skuqur në fytyrë dhe, siç m'u duk së largu, balli i ishte djerishtur.

Xhelaja tha se punën e magazinierit mund ta bënte edhe normistja. Pashë Dianën në sy. M'u duk sikur ajo ia nguli sytë inxhinierit që kishte në krah. Në presidium ishin katër minatorë dhe sekretari i byrosë së organizatës së Partisë. Pas shumë mbledhjesh po vija re se nuk u lexua asnje raport. Vetëm sekretari mbante shënime në bllokun e tij dhe inxhinieri diçka shënonte në kurrizin e paqetës «Ardian».

Xhelaja e quajti këtë problem të mbaruar, kur papritmas u ngrit inxhinieri dhe tha shkurt:

— Diana nuk mund të merret me magazinën. Telashet e furnizimit nuk mund t'i mbajë në kurriz një vajzë.

Këto fjalë më revoltuan shumë. Nuk e dija se për çfarë lloj vajzash fliste inxhinieri, po për vajzat si Diana unë vija bast se ato, po ta sillte rasti. mund të punonin edhe në galeri. Besoja se inxhinieri e shikonte Dianën si një vajzë sentimentale e të pa-fuqishme, ose e mbronte Ramon aq keq, sa s'bëhej më. Një varg i gjatë mendimesh e ngjarjesh nisën të më lëvrinin në kokë. Diskutonim për dy njerëz, të cilët unë i njihja mirë, sado që Ramon më tepër se Dianën. Vajza kishte ardhur të punonte në eks-peditë pas gjimnazit, po drojtjen e parë në mes të

këtij kolektivi burrash e kapërceu quditërisht shpejt, Nuk vonoi dhe ajo u bë motra jonë, vajza jonë, njeriu që ne filluam ta donim më shumë.

Diskutimet nisën përsëri të furishme rrëth ngarkesës në punë të Dianës. Këtu ajo u bë lulëkuqe në fytyrë, uli sytë dhe shikoi duart. E ndjeva se atë kohë ajo po kalonte një çast shumë të vështirë, kur befas u ngrit e tha:

— Më vjen më tepër turp për atë që ka kaluar. Shpesh nuk kam pasur me se të merresha. Ato kanë qenë orët më të mërzitshme të jetës sime. Po kjo nuk më justifikon. Unë tani mund të them që e bëj edhe detyrën e magazinierit.

Këto fjalë i stepën të gjitha debatet. Pllakosi një heshtje e gjatë. Ramoja i kishte ngulur sytë mbi vajzën. Besoja se ishin të vetmit sy të ligj. Vështrimet e tjera ishin të qeshura. Sytë e inxhinierit shprehnin haptazi ironi. Ramoja pa nga unë. Në shikimin e tij dallova lutje për ndihmë. Nuk kisha folur akoma, por dëshiroja t'i thosha me zë të lartë gjithçka mendaja. Kjo ishte një dëshirë e fuqishme dhe besoja se do të më kuptonin të gjithë. Më shumë doja të më kuptonte Ramoja. Vetëm po t'ia thosha kësntu, fare hapur të gjitha, kisha shpresë se do ta ndihmoja. Prandaj, kur më erdhi radha të flitja, tregova këtë ngjarje të freskët...

Atë ditë ne u nisëm rrëth orës tre mbasdite. Ko- ha ishte e vrenjtur dhe dëbora kishte zënë fshatrat që shtriheshin në shpatet e maleve rrëth e rrotull qytetit. Kjo vonesë për atë rrugë aq të largët erdhi ngaqë ne pritëm shokët të dilnin nga mbledhja e Partisë. Ramoja kishte marrë nga magazina qendrore

njá dhjetë kile karbit dhe ca materiale të tjera, të cilat ishin të domosdoshme për të mos u pezulluar puna në ekspeditë. Shoferi ishte më i shqetësuar nga të gjithë.

— Po bëhem shumë vonë, — më tha mua. — Deri në Gozisht duhen të paktën dy orë rrugë. Edhe sikur tani të nisemi, atje do të mbërrimë në të errët. Pastaj ju do të vazhdoni rrugën. Natën është shumë vështirë të udhëtosh.

Nuk dija si t'i përgjigjesha. Vërtet ishim shumë vonë. Diana ishte ulur aty afér meje, mbi një stivë shtyllash galerie dhe shikonte herë njërin dhe herë tjetrin. Ky ishte udhëtimi i saj i parë që i takonte ta bënte më këmbë. Herë të tjera ajo kishte ardhur me makinë deri në vend.


Në këto e sipër, mbledhja e Partisë mbaroi. Me ne erdhën xha Xhelova dhe Sotiri. Pa u vonuar, hi-pëm në karroceri. Diana, përpara me shoferin. Tani vura re se në makinë kishte ca pjesë këmbimi për motorë, dhjetë a dymbëdhjetë baromina pistoleta dhe ca palë çizme gome.

— Kemi dhe këto të flamlosura, — tha Ramoja, duke treguar materialet. — Me se do t'i çojmë në vend, xhanëm? Një fjalë dinë të të thonë: merr, merr, merr! Se si çohen këto në fund të dynjasë, atë nuk ta thotë askush. — Ai ishte mbështjellë me shallin e trashë dhe fytyra e imtë, futur midis jakës së palltos, i dukej fare e vogël.

— Do mundohemi të gjejmë ndonjë kafshë në Gozisht, — i thashë aty për aty.

— Avaze..., — murmuriti ai.

Diku qëndruam të hanim bukë dhe po aty filloj shiu. Një shi i imtë dhe i ftohtë. Kamerieri tha se në male duhej të binte déborë. Dhe vërtet, nga dri-



2104

tarja dukej Qafa e Lajthizës, e mbyllur me një përde të zezë mjegulle. Retë ngriheshin e uleshin mbi shpatet e thepisura të maleve, zbrazeshin nga lagështia dhe, të lehtësuara e të bardha, ngriheshin përsëri lart si balona të deformuara.

Në të hyrë të Rehovës filloi një breshër i imtë. Xhelaja tha se ky ishte shtrat dëbore. Retë vërtiteshin mbi kokat tonë si të tërbuara. Kjo ishte një lëvizje aq e furishme, sa, me gjithë trashësinë e reve, herë pas here zbulohet kaltërsia e qelliit dhe dielli na e bënte me sy, si një çamarok që luante kukamshehtas me ne.

— Ky shtrat bore kaq i furishëm, — tha Sotiri, — mbasë na e hap kohën. Qielli po çahet.

— Ishallah..., — murmuriti Ramoja.

— Se pse kam përshtypjen se duhet të vemi me makinë deri në ekspeditë, — thashë unë. — Rruja deri këtu nuk ka pikë dëbore. Më lart ndoshta nuk i kalon as të njëzet centimetrat. Është akoma butë. Ngrica nuk ka pasur.

— Jo, — tha Xhelaja, — shtrati i dëborës pret jorganin që ta mbulojë. Unë kalova edhe dje nga kjo rrugë. E shikon kurrisin e Rehovës? Mbrëmë nxinte e sot zbardh. Në Gozisht duhet ta ketë kaluar pëllëmbën.

Heshtëm. Makina e cte ngadalë e gulçonte nga e përpjeta e fortë. Po futeshim në Qafën e Lajthizës. Mendoja se, në qoftë se nuk do ta kishte krijuar erozioni këtë qafë të ngushtë, me siguri Gozishti do të mbetej edhe për një kohë të gjatë akoma pa rru-gë makine. Në të dyja anët ngriheshin ca shpate të egra, shumë të thepisura. Dëbora kishte qëndruar vetëm në shkallët e shtresëzimeve, sepse shkëmbinjtë

në ato faqe malesh radhiteshin njëri mbi tjetrin horizontalisht.

Mirëpo në Qafë të Lajthizës e pashë se sa i gabuar isha. Më parë se ne duhej të kishin kaluar nga dy makina të tjera që kishin çarë rrugën. Dëbora ishte aq e madhe, sa, me gjithë fuqinë e rrotullimit të gomave, tabani i rrugës nuk dukej gjékundi. Pas qafës shtrihej fusha e vëtmuar e Gozishtit. Fshati do t'u ngjante atyre kartolinave të pikturuara që dërgojnë për Vitin e Ri, sikur mbi kokë të kishte një qjell të kthjellët. Po qelli nxinte. Pashë orën. Po i afrohej pesë e gjysmës. Në të vërtetë ishte fundi i marsit dhe kjo dëborë dhe ky të ftohtë ishin shumë të vonë. Sotiri tha rrugës se, siç kishte nisur, dimri duhej që së shpejti t'ia linte vendin beharit, sepse janari e shkurti kishin bërë nxeh të dhe tani marsi i ngjante dhjetorit. Filloi një dëborë e imtë, fare e imtë. Fusha e bardhë i ngjante një çarçafi të madh. E rrafshtë, e gjatë dhe e ngushtë.

Qëndruam në qendër të fshatit. Ndërsa Ramoja u nis të gjente ndonjë kafshë, ne të tjerët hoqëm kë-pucët dhe veshëm nga një palë çizme. Shoferi nuk doli fare nga kabina. Diana vështronë fshatin. Dukej fare e nemitur. Thëllimi sillte tani një dëborë të pjerrët, të fuqishme, po çuditërisht të imtë.

Që të mos ftoheshim derisa të vinte Ramoja, u futëm në korridorin e zyrave të kooperativës. Ishte vonë dhe aty nuk kishte asnjë njeri.

— Diana! — i thashë vajzës, që m'u duk atë çast e menduar. — Ti mund të kthehesh me shoferin. Mjaft jemi ne katër vetë. Fundja eja pasnesër. I thonë gati prill dhe nuk besoj të bien qiejt. Pastaj ti nuk ke as ndonjë punë me ngut.

— Nuk ndahem nga shokët, — tha ajo. — Besoj

se éshtë kënaqësi të udhëtosh nëpër dëborë. Nuk kam pasur rast tjetër.

— Sikur të ishte kohë e mirë, — tha Sotiri, — po sot?...

— Bashkë me ju, — u përgjigj ajo.

Ramoja u kthye së bashku me një gozishtas, i cili mori përsipër që materialet tonë t'i sillte në ekspeditë të nesërmen, sepse në atë orë, sipas tij, çdo udhëtim do të ishte një çmenduri. Bile na ftoi edhe ne të kalonim natën në shtëpinë e tij.

I kundërshtuam të gjithë, përvèç Ramos.

— Janë tri orë rrugë, — tha fshatar, duke qeshur me mosbesim. — Ju nuk mund ta njihni Zarelin më mirë se unë. Rruga as që éshtë shkelur dhe dëborën duhet ta ketë stivosur era atje ku ju nuk e pandehni. Pastaj kjo vajzë me ju...! — shtoi ai përsëri me mosbesim. Nguli këmbë aq shumë përtë qëndruar atë natë tek ai, sa edhe ne u lëkundëm. Vështruam njëri-tjetrin. Po pikërisht atë çast Xhe-loja tha se ne duhej të niseshimi patjetër, sepse shokët na pritnin.

— Në qoftë se ti nuk na jep kafshën, — përfundoi ai, duke iu drejtuar fshatarit, — ne duhet t'i marrim në krahë një pjesë të materialeteve, përtë cilat do të kemi nevojë më shumë.

— Kjo nuk bëhet! — kundërshtoi haptazi Ramoja. — Kokën do të çojmë gjallë, apo materialet? Arsyjeja duhet të na thotë se nuk kemi për se të rrezikohemi kot së koti. Ky njeri po na lutet, — shtoi ai përgozishtasin, — dhe ne po e shpërblejmë me mospërfillje.

— Ne e falënderojmë për kujdesin, — thashë unë, — po ne s'po mendojmë vetëm përvete. Shokët

na presin dhe ti, Ramo, e di mirë se galeritë nuk kanë asnjë kile karbit.

— Se u pezulluan dy turne, nuk bëhet kiameti,

— m'u përgjigj aty për aty bashkëfshatari im. — Në të tilla kushte punojmë, majë maleve e në mes të dimrit.

U grindëm një kohë të gjatë. Ramoja bile u bë gati të shkonte me fshatarin në shtëpinë e tij. Më erdhi aq inat, sa, pa ia bërë të gjatë, e hoqa mënjanë dhe i thashë:

— Po bëre këtë, nesër mos u duk më në ekspe-
ditë. Kjo është vajzë, — i thashë për Dianën, —
dhe nuk po kthehet. Ç'mbetet për ty?

— Fundja nisemi, — tha ai. — Por unë për vete
nuk marr asgjë nëpër duar.

Fshatari iku. Ne shkarkuam ato pak materiale
nga makina. Çizmet i kishim mbathur qysh më parë.
Karbitin dhe pjesët e ndërrimit për motorët i shpër-
ndamë nëpër çantat tonë. Barominat e pistoletës i
ndamë nga katër copë secili. Dianës i dhamë dy ca-
nta. Ramoja mbajti vetëm çantën e tij. Dukej kaq i
dobët e si i lodhur qysh pa u nisur, sa më vinte t'ia
kërcitja fytyrës me grushte. Për herë të parë e ndje-
va qartë se sa shumë kishte ndryshuar ai njeri. Dhe
besoja se puna e paktë që bënte në magazinë e kishte
bërë të tillë. Ai ishte ndarë nga ne, që luftonim çdo
ditë me shkëmbin dhe ishte bërë një qull i vërtetë.

U mblozhëm edhe një herë pranë njëri-tjetrit.
Ora kishte kaluar nga gjashta, por, po të ishte ko-
hë e mirë, dielli sapo do të kishte perënduar. Tani
dukej si pragu i natës.

— Diana, kthehu, — i thashë vajzës edhe një
herë.

Shoferi shikonte furinë e dëborës. Kabina sa vinte ngarkohej dhe xhamet po zbardheshin.

— Jo! — tha ajo. — Nuk keni pse të ngulni këmbë. Xha Xhelox, sikur kishe edhe një kapë tjetër. Ma jep mua.

Xheloxa nxori nga çanta një kapelë doku të zberdhulur. Ajo e vuri në kokë, mbuloi veshët e vegjël më anët e saj dhe, pasi hodhi dy çantat në supë, tha:

— Para, shokë!

Shoferi, pasi na uroi rrugë të mbarë, ktheu makinën dhe iku.

Ne qëndruam edhe disa sekonda. Thirrja e Diana-s na grishi përrrugë.

Xheloxa që ecte përpara saj, zhytej e mezi shkulej nga dëbora, e ne të tjerët, atëherë kur acari të merrte frymën, po na mbulonin djersët. Pas pak dola përpara. Dukeshin gjurmë të zbeta kalimtarësh, që ngadalë po i mbushte dëbora e re. Ruga që gjarpëronte nëpër një shteg përroi malor, rënkonte nën këmbët tonë. Për çudi vetëm këmbët po më ftohen. Gishtat sikur m'i kishte mbërthyer dikush me pincë. Trupi valë, dhe këmbët akull! Ecja dhe ktheja kokën pas. Pritja që Diana të lodhej ose të thoshte së paku se duhej të pushonim diku. Po nuk po ndodhte asgjë e tillë. Faqet e saj kishin marrë ngjyrën e moliës së pjekur, të kuqe e pak të verdha. Njollan-jolla. Sytë i qeshnin në mënyrë të çuditshme. Mua nuk më vinte aspak për të qeshur. Horizontet ishin ngarkuar rëndë me dëborë. Ajo dukej kaq e zezë tek zbriste nga qielli, sa ç'do të dukej e bardhë kur do të prehej në gjirin e tokës.

Qafën e atij mali e ngjitëm të gjithë së bashku. Pastaj gjurmët e rralla bënin një kthesë dhe i afro-

heshin rrugës automobilistike malore. Aty Ramoja u nda nga ne. Ai i ra mes për mes një fushëze dhe të gjithë e kuptuam se synonte të dilte në qafën tjetër më parë nga ne. Kishte një hap të shkurtër, të ngathët dhe mbi dëborë dukej çuditërisht i vogël.

— Kthehu! — i thirra unë. — Andej ka gropë.

Por ai nuk më dëgjoi. Murlani i përzier me dëborë m'i shtynte fjalët drejt jugut.

Udhëtuam kështu afër një orë. Nata kishte zbritur tashmë mbi kokë aq e errët dhe kërcënuese, sa na rrethoi nga të gjitha anët si një armik i pabesë. Pushuam vetëm pesë minuta. Sotiri tha se, po të rrinim më shumë, do të ftoheshim dhe nuk do të ishim më në gjendje të ngriheshim.

— Më vjen aq gjumë, — tha Diana, — sa do të falja dy vjet jetë, po të më linin të flija dy orë.

Iu afrova vajzës dhe i thashë të ma jepte mua njérën nga çantat. Nuk pranoi. Bile u ngrit dhe doli përpëra. Kështu e humba nga sytë, për afër gjysmë ore...

Po zbritnim një të tatëpjetë. Ramoja rënkonte pas meje. Një herë shau aq ndyrë për fatin që e kishte sjellë në ato anë, sa nuk u përbajta më. Ndala këmbët, u ktheva nga ai dhe i thashë:

— Qenke bërë më keq se një skile! E di unë për se ke nevojë ti!

— E di ç'ke ti? — më tha duke më afruar fytirën e tij të zbetë. — Ec dhe mos më çaj dërrasa!

Pështyva përtokë dhe vazhdova rrugën. Nisa të mendoja se sa poshtë mund të bien njerëz të tillë! Sa më shumë t'i mbështjellësh me pupla, aq më të dobët dhe më të shëmtuar bëhen. Ramoja, për shembull, kishte ndryshuar aq shumë, sa nuk njihej më. Kishte filluar të mbante kravatë dhe në mbledhjet

e kolektivit ishte i zoti të nxirrte lloj-lloj justifikimesh kur e kritikonin. Një herë ia hidhte fajin shefit të furnizimit të ndërmarrjes, një herë shoferëve që «nuk pranonin të vinin në këtë ekspeditë të thellë» e më shpesh konjunkturave ndërkombëtare që pengonin importin. Habitesha me këtë lloj «oratorie» dhe sa më shumë kohë kalonte, aq më tepër bindesha se ai po bëhej më llafazan se kurrë. Dhe për se pa, ia shtonte vetes këtë cen? Për tu justifikuar. Ditë të tëra ai luante tavëll. Më kishte rastisur të hyja në magazinë, i zbardhur nga pluhuri i gëlqerorit të galerisë, kur dëgjoja Ramon të bërtiste:

— Shesh-besh! Fluturoi dopjoja e rakisë!

Nuk e honepsja dot më. Por edhe ai nuk më afrohej si më parë. Unë shkoja vetëm një herë në muaj në shtëpi, kurse ai gati çdo javë. Së andejmi më sillte ndonjë lajm a letër, dhe vetëm kjo lidhje kishte mbetur nga miqësia jonë e dikurshme.

Vazhdonim të echim. Tani hapat i hidhja kuturu. Gjunjët më dridheshin nga lodhja. Débora kishte filuar të ngrinte dhe mezi çuhej. Këmbët na shkitnin. Gishtat e njérës dorë më ishin mpirë ngaqë me ta kisha mbërthyer katër barominat që mbaja në sup. Më tej njérën prej tyre nisa ta përdorja si shkop. Me këtë rast kontrolloja dhe trashësinë e déborës. Ramon e lashë pas, pas lashë edhe Xhelon. Diana ecte pas Sotirit. Era kishte pushuar dhe débora binte pa u ndier. Diku dëgjohej shushurima e shurdhër e ujtit të një përrroi.

— Këtu ka një shtresë me mineral, — tha Sotiri. — Ma ka treguar një ditë inxhinieri kur kaluam këndeji. Ndoshta do ta fillojmë punën edhe këtu.

— Si është vendi? — pyeti Diana.

— Siç e shikon, — ishte përgjigjja.

— Po unë nuk po vë re asgjë, — tha ajo.

Qeshëmi.

— A u lodhë, Diana? — i thashë.

— Po, — m'u përgjigj, — më shumë më dhembin gjunjët... por do të më kalojë. E kemi bërë gjysmën e rrugës?

— Më tepër. Për ndonja gjysmë orë duhet të zgresim në rrugën e makinës. Pastaj e kemi të lehtë. Së andejmi ekspedita nuk mban as njëzet minuta.

— A kanë vajtur punëtorët në turn? — pyeti ajo.

— Patjetër! — tha Sotiri. — Në galeri bën ngrohtë.

— Epo, ecim, — tha Diana dhe pshëretiu.

M'u duk se ajo mori kurajë pikërisht ngaqë punëtorët kishin shkuar në turn. E ndjeva gjithë domethënien e pshëritimës së saj dhe besova për një çast se asaj i erdhi turp nga vetja që tregoi dobësi. Kjo vajzë po na hynte në zemër të gjithëve. Mbaja menj se si një ditë, duke udhëtuar me makinë, diku ngecëm. Gomat xhironin në lagështirë. Ne e ngarkuam me gurë-karrocerinë bosh dhe pastaj nisëm ta shtynim. Diana e shtynte së bashku me ne, me gjithëse gomat shkëputnin nga rruga copa balte dhe na i përplasnin në fytyrë e në rroba. Ajo bërtiste: «forca, forca» dhe na jepte kurajë të gjithëve. Në galeri, kur kishte ardhur një ditë të kronometronte operacionet e punës, m'u lut t'i jepja pistoletën dhe vendosi ta mbaronte vetë njérën nga birat. Të gjitha këto ma bënин aq të afërt, sa nuk kisha asnje dyshim se ajo ishte vajza jonë, vajza e klasës.

Ecja dhe nuک doja ta humbisja nga sytë. Ishte aq errët, sa i dalloja vetëm siluetën. Shpesh ndry-

shonte rrugën, zhytej në dëborë dhe mezi shkulej së andejmi. Sotiri çante rrugën. Errësira nuk na bënte më përshtypje. Edhe dëbora po binte e rrallë e flokëvogël. Nuk ndieja më të ftohtë. Malet përreth ishin fare të zhveshura dhe era fishkëllente tek përplasej pas shkëmbinje.

Besoja se nuk na duhej më shumë se një çerek ore të dilnim në rrugën automobilistike, kur befas ndjeva se kisha mbetur i fundit. I thirra shokët me emër. M'u përgjigjën të gjithë, përvèç Ramos. Ne e thirrëm së bashku disa herë me radhë, po nuk morrëm asnjë përgjigje. Sotiri, që kishte ecur në krye prej më se një orë, besonte se Ramoja nuk kishte kaluar përpara. U shqetësova mjaft. U thashë se duhej të kthehesha mbrapa.

— Do të kthehem i tij — tha Xhelaja. — Ti, Diana, a mundesh?

— Po, — tha ajo, — mundem.

E pashë vajzën me keqardhje. E dija se ishte e këputur nga lodhja, megjithatë ishte po aq e rrezikshme ta lije vetëm në mes të natës në dëborë. I thashë xha Xhelos të qëndronte me të dhe të kthehemishim vetëm unë e Sotiri. Nuk pranuan. Dhe unë nuk e zgjata. Pata përshtypjen se, po të ngulja këmbë, do ta trajtoja atë vajzë më keq se një fëmijë.

U kthyem. Ecnim dhe i thërrit nim Ramos në emër. Zërat tanë kumbonin të shurdhër midis maleve.. Sotiri tha se britmat i mbyt dëbora dhe nuk dëgjon më larg se njëqind metra. Asgjë nuk më shqetësonë më shumë nga mendimi se Ramoja mund të qe rrëzuar gjëkundi dhe të qe vrarë. Dritë nuk kishim.

Po nuk na u desh të bënim shumë rrugë. E gjetëm shpejt, të ulur mbi dëborë e të mbështetur rrëzë

një shkëmbi. Çantën e kishte lëshuar ndonja dhjetë metra më tej. Tek e pashë ashët të drobitur e të dërrmuar nga lodhja, të them të drejtën, e përzuza. Megjithatë nuk ishte aspak koha dhe vendi për t'i folur. I fërkova fytyrën dhe duart me dëborë dhe i dhashë dorën të ngrihej. Diana i mori çantën. Ekte kokulur dhe këmbët mezi i zvariste. Dy-tri herë deshi të ulej përsëri, por unë nuk e lashë. Më vinte turp nga shokët që ai e kishte lëshuar veten aq shumë. Sidomos nga Diana. Gjithë rrugën, derisa mbërritëm në ekspeditë, ai ndalonte herë pas here dhe ulej. Ne e pritnim. Njëherë u mata ta merrja në krahë dhe të ecja me të. Isha aq i indinjuar, sa nuk pyetja as për lodhjen dhe as për dëborën. Nuk e bëra vetëm sepse paskëtaj do të binte më poshtë nga ç'kishte rënë.

Dy ditë me radhë nuk u ngrit nga krevati. Kurse ne të tjerët e filluam punën që pa gdhirë.

Këto të gjitha ua tregova shokëve në mbledhje. Besoja se Ramoja do të më kishte kuptuar drejt. Por, edhe në qoftë se nuk i pëlqeu që i thashë të gjitha aq haptazi, nuk më prishej shumë puna. Ai do të vinte së bashku me mua të punonte në galeri dhe atie me siguri do të mësonte jo vetëm se si të ekte tri orë në dëborë më këmbë, po do të bëhej edhe shoku im më i mirë.

DEMIRI

Atë ditë ra dëborë. Një dëborë e trashë, flokërendë, që mbuloi degët e zhveshura të pemëve, përrallet, ilqet, ferrat. Mbasdite vonë, nën dritën e atyre pak rrezeve që vinin nga perëndimi, toka dukej e bardhë në të kuqërreme. Kjo flakërimë buronte nën kufirin e një mase të trashë mjegulle, që dielli e kishte të vështirë ta copëtonte. Vonë nisën të shqueshin rrugët e bardha të shkelura nga njerëzit, si ca vija të përdredhura që u ngjanin gjurmëve të një gjiganti zvaritës. Filluan të pikonin strehët prej eteriniti të barrakave dhe dy orë më vonë, thuajse afër muzgut, nën çatitë nisën të formoheshin stalaktitet e akullta që zgjateshin kokëposhtë në drejtim të tokës së bardhë. Gjithçka ishte mbuluar me atë bardhësi të ftohtë. Në prag të muzgut dëbora binte në sy më tepër. Errësira ngjitej nga lugina në drejtim të majës së malit ngadalë, e druajtur, e ngjashme me mjegullën, në dyluftim me reflekset e bardhësisë që buronin nën tabanin e saj.

Nga barrakat dilte një tym i bardhë dhe dritaret e vogla me dy palë xhame pikonin nga avulli. Xha Stefani dremiste i ulur në një stol të drunjë pranë sobës. Në fytyrën e plakut ishin thelluar dy rrudha të mëdha dhe mustaqet e shkurtra i ngriheshin përm

pjetë nën forcën e frysë që i dilte nga buzët. Dhoma kishte tri krevate marinari dhe një tavolinë të vogël me mbulesë jeshile. Mbi tavolinë shtriheshin ca fletë të thara duhani, një copë dërrasë gjithë të prera dhe thika e madhe, me të cilën plaku grinte duhanin. Ai kishte mbështetur njérën dorë në ballë, duke shtyrë kësisoj kapelen pranë qafës. Herë-herë përmendej nga dremitja dhe hidhët sytë në shtratin e sipërm të cepit, ku flinte Demiri. Djali flinte gjysmë i zbuluar, me një këmbë të mbledhur pas bar-kut e tjetër të shtrirë. Xha Stefani njëherë e pa që zgjati edhe këmbën tjetër, hoqi tej batanijet e leshta dhe futi kokën nën jastëk. Vështroi orën.

«Le të flejë edhe ndonjë orë akoma», — mendoi. **U** ngrit ngadalë dhe vajti ta mbulonte. Djali lëvizi përsëri.

«Është vërtet shumë i ri akoma!» — mendoi plaku duke e vështruar një çast në fytyrë.

Ul përsëri në vendin e vet afër sobës. I futi një dru dhe nisi të kujtonte ditën e parë, kur Demiri kishte ardhur në ekipin gjeologjik. E kishte sjellë një kushëri i tij i largët që punonte edhe ai aty...

...Megjithëse kushëri i Demirit kishte biseduar edhe më parë me teknikun, prapëseprapë ndodhi diçka e papritur: djali që vinte të punonte në galeri si ndihmësminator, dukej kaq i ri, sa tekniku rrudhi buzët sa e pa. Demiri ishte trupshkurtër, rondokop, kishte ca buzë të holla që nënqeshnin më turp, sy të vegjël çuditërisht të gjallë, që flitnin më shumë se gjithçka. Takimi i parë midis tyre ndodhi në sallën e mensës. Kuzhinierja pa nga sporteli i vogël me një nënqeshje ironike në drejtëm të djalit.

— Ti duhet ta kuptosh, — i tha tekniku ku-

shëririt të Demirit. — Djali është shumë i vogël dhe nuk mund ta marrim në punë. Nuk dua ta fyej, po ma ha mendja se as pistoletën nuk e mban dot.

— Ndoshta nga pamja duket i vogël, — u përgjigj kushëriri, një minator trupmadh, i shëndoshë, me hundë të kthyer poshtë. Një kaçurrel, si të ishte një bri, i lëshonte hije mbi ballin e lartë. — I ka mbushur të tetëmbëdhjetat dhe është i fortë. Fundja, ne e mbajmë ca kohë. Në qoftë se nuk do të mundë...

— Nuk bëjmë prova me njerëzit! — iu përgjigj ashpër tekniku. — Është shumë e dëmshme edhe për shëndetin e tij. Mua më vjen keq, por...

— Fundja e marr vetë, të punojë me mua, — u nxitua të thoshte kushëriri i Demirit.

Djali rrinte aty në cep të tryezës dhe kishte mbërthyer fort me duar anët e saj. I vinte t'i thoshte atij tekniku se ishte shumë më i fortë se si dhe, po të dëshironte, le t'i matnin forcat së bashku. Tekniku ishte një burrë thatim, rreth të tridhjetave, i dobët dhe i hollë si një fije shkrepëse dhe Demiri pati përshtypjen se më ato këmbë si cingël atë mund ta merrte era, po të dilte përjashta.

— Këtu nuk mund të të ndihmoj, — tha tekniku. — Nuk është fjala te paga më tepër, se sa për shëndetin e tij.

Xha Stefani, që e dëgjonte këtë bisedë disa tryeza më tej, e pa djalin për herë të parë me vëmendje. Për çudi, atij nuk iu duk aq i vogël sa thoshte tekniku. Atë, për vete, që pesëmbëdhjetë vjec e kishin futur të gërmonte pusin e thellë të Rubikut në shoqërinë italiane të atëhershme. Iu kujtua se në atë kohë askush nuk ishte interesuar për moshën e tij. Kishte braktisur shtëpinë dhe, në vend që të thellonte minierat e mërgimit, si shumë

bashkëfshatarë të tij bregdetas, kishte vendosur të vente në Rubik. Djali që kishte tanë para sysh, i dukej si djalë qyteti. Mbante veshur një pallto të shkurtër, të trashë, pantallona të ngushta dhe kë-pucë të reja. Qafën ia mbështillte një shall i leshtë me katrorë të mëdhenj...

— Kam mbushur të tetëmbëdhjetat..., — dëgjoi që foli për herë të parë djali, — mund të punoj kudo.

Plaku kishte vënë re se si ishte skuqur ftyra e tij e rrumbullakët dhe një shprehje ironie iu shfaq në cepat e buzëve.

Që atëherë kishin kaluar katër muaj. Tekniku ishte bërë i dashur me Demirin po aq sa edhe me të tjerët.

...Xha Stefani nisi të dremiste përsëri. Ngroh-tësia e sobës i sillte një kënaqësi të veçantë. Befas u zgjua dhe ndjeu se në barrakë kishte rënë qetësi e thellë. U tremb se mos kishte kaluar ora të zgjonte Demirin. U ngrit dhe i zbuloi ftyrën.. Djalit i doli gjumi me vështirësi. Fërkoi një copë herë sytë e buhavitur dhe pyeti:

— Vajti vonë, hë?

— Jo... jo, ke kohë.

— Bie më dëborë?

— Ka pushuar. Më duket se nesër do të kemi kohë të mirë.

Ashtu i zhveshur siç ishte, u hodh nga kati i siperëm i krevatit dhe mori nga gozhda kominoshet. U vesh shpejt dhe, tek mbathtë çizmet, dëgjoi xha Stefanin t'i thoshte:

— Unë po marr tanë një sy gjumë. Nga ju do të vij të bëj plasjen e minave në të gdhirë.

— Kur të duash, eja, — iu përgjigj Demiri. —

Besoj së rreth orës pesë të mëngjesit do të kemi mbaruar.

Plaku zhveshi peliçen, këmishën dhe zbuloi para djalit një gjoks të shëndetshëm leshtor e të thinjur, mbështjellë me fanellë leshi.

— Nuk mbarova së griri edhe këtë të flamosur!

— tha nëpër dhëmbë, duke treguar duhanin mbi tryezë. — Kujdes në Sheshet e Mëdha. Ka gropë dhe dëbora të gënjen. Natën e mirë!

— Natën e mirë, xha Stefan!

Doli nga barraka dhe hodhi hapat e parë në dëborë. U habit sa shumë kishte shtruar. Në mensë nuk kishte mbetur njeri. Kuzhinierja lante pjatat dhe priste të hante vetëm ai.

— Me Nazon je sot? — e pyeti ajo, sapo ë patë hyntë në sallën e mensës akoma i përgjumur.

— Po, — tha ai. — Paska rënë shumië dëborë, — shtoi duke vështruar nga dera. — Vështirë do ta ketë të vijë nga fshati.

Këto fjalë i tha duke murmuritur. Ora po i afrohej dhjetës. Hëngri shpejt e shpejt dhe doli. Një copë karbit e mbëstolli me letër dhe hodhi në sup dy baromina pistolete.

Rugua deri në galeri ishte një e përpjetë e fortë. Këmbët e zhytura në çizme i rrëshqitnin. Dëbora kishte filluar të ngrinte. Në qìell digjinin yjet. Ca yje të vogla, shumë të largëta, të pakta, që dridheshin në hapësirën blu. Frynte erë e lehtë dhe copat e dëborës që shkëputeshin nga drurët e lartë, i freskonin fytyrën. Nisi t'i djersinte trupi dhe nuk e ndiente më atë lodhjen e parë që të pret këmbët, kur sa fillon e ngjitesh.

Mbërriti në Sheshet e Mëdha ku ishin vendosur motokompresorët, thuajse më dhjetë e gjysmë. Roja

i doli pérpara i mbështjellë me mushama të gjatë deri në fund të këmbëve, me kapuç, dhe në atë errësirë të thellë ftyra mezi i dallohej.

— Ftohtë, hë?! — murmuriti ai, duke fërkuar duart. — Si u ngryse?

— Faleminderit, — tha djali. — Nuk është edhe aq. Atë kohë atij i shkitnin kurrizit rrëke të holla djerse nga e përpjeta që sapo kishte ngjitur. — Nuk ka ardhur akoma motoristi?

— Jo, — tha roja, duke shtyrë pakëz mbrapa kapuçin.

— I thuaj ta lëshojë ajrin kur t'i biem ne vagonit. Nazoja ka ardhur gjë?

— Nuk është dukur akoma.

— Natën e mirë!

Roja nxori një tingull të papërcaktuar. Rruga tani vinte e sheshtë dhe djersa nisi t'i thahej. Ca si gjilpëra të holla filluan t'i shponin trupin.

Turni i dytë sapo kishte mbaruar. Minatori i ndriçoi ftyrën me dritën e paktë të llambës dhe, kur i pa barominat në sup, i tha:

— Ke bërë mirë që i more. Fronti është shumë i fortë. Ne thyem katër copë. Nuk ka mina të plasura.

Ata u larguan nëpër errësirë. Ai mbeti vetëm. Vagoni i fundit ishte ende i pazbrazur, aty në fund të shinave.

«Po rregulloj llambën sa të vijë Nazoja!» — mendoi.

Nazon e priti më tepër se një orë. Të ftohtët sa vinte dhe bëhej mië i padurueshëm. Po afrohej mes-nata. Qetësia e thellë kishte pushtuar hapësirën që shtrihë para tij. Galeria ishte hapur në një faqe mali nga shihej tani natën një hapësirë e gjerë, kujeta

binte ngadalë në gjumë. Këtë ai e ndiente më tepër nga numri i dritave që sa vinin e zvogëlosheshin. Dëbora dukej si e murme. Ai qilim vigan kishte mbështjellë kodrat, përrrenjtë, drurët...

«Ka rrezik të na ngrijë përsëri tubacioni i ajrit», — mendoi befas.

Iu kujtua ç'kishin hequr ndonjë muaj më parë. Temperatura kishte rënë disa gradë nën zero. Ajri nëpër tubat e çeliktë ishte lëngështuar, pastaj kishte ngrirë. Dy turne nuk kishin punuar fare. Pastaj njëri nga punëtorët kishte propozuar të ndiznin zjarre gjatë gjithë linjës së tubacioneve. Dhe ashtu bënhë. Kishin harxhuar vërtet ca naftë, po flaka që përshkoi pastaj, bëri efektin e duhur. Shiriti i zjarrtë ishte përhapur me një shpejtësi të çuditshme nëpër dëborë si një përbindsh, derisa i ishte afruar galerisë. Motoristi kishte ndezur motorin. Në galeri shpërthyen copa akulli. Pastaj ajri i thatë ishte përplasur pas mureve të errëta të nëntokës.

Nazon e priti edhe gjysmë orë akoma. Pastaj u ngrit, ndezi llambën dhe zbrazi vagonin. E vërteta është se mezi e përbysë, sepse ata të turnit të dytë e kishin mbushur me majë.

«Po vete brenda ta mbush», — tha me vete. «Ndërkohë Nazoja do vijë.»

Vari llambën në ballë të vagonit dhe e shtyu drejt thellësisë. Nëntoka sikur buronte një nxehësi dashamirëse. Flaka e verdhë e llambës hidhte mbi armaturat një dritë të zbetë dhe pas tyre dallosheshin hijet e drurëve të lagur. Galeria ishte afër treqind metra e thellë dhe e drejtë si me pe. Ekte duke menduar se, me sa kishte thënë tekniku, minerali tanë duhej të ishte shumë afër. Buzëqeshi. Vagonit i

dha më me forcë dhe ndjeu se si rrëshqiti më shpejt mbi shina.

Kishte nxjerrë tre vagona dhe Nazoja nuk po dukej të vinte ende. Vuri veshin të dëgjonte më mirë. Qetësia e thellë prishej kësaj here nga zhurma që vinte nga Sheshet e Mëdha. Dritat në qendrën e ekipit qenë fikur të gjitha.

«I ka ndodhur diçka, me siguri!» — mendoi ai për Nazon dhe pér herë të parë u dridhërua. I mun-gonte minatori dhe as që kishte si të punonte pa të. Si do t'i bënte birat e minave vetë? Po sikur të shtrembëronte galerinë?

Në raste të tilla ai kishte dëgjuar minatorët të thoshin se duhet kthyer në bazë. Nuk mund të punosh i vetëm nën tokë. Tekniku kishte paralajmëruar disa herë pér këtë gjë. Sepse rreziku... «Sa po vonohet edhe ky Nazoja. Apo mos ka ndonjë fëmijë sëmurë? Sa të kem mbaruar unë sterilin, ai ndoshta do të vijë.»

U nis përsëri në drejtim të nëntokës. Diku në thellësi të galerisë tavani pikonte vazhdimisht dhe ata vendosnin një kavanoz pér të mbledhur ujë. Ai e dinte thuajse symbyllazi se ku ndodhej kavanozi. Ndali vagonin dhe piu ujë. I hodhi edhe llambës. Shtyu vagonin dhe eci në drejtim të ballit.

Ata pesë vagona me steril e kishin lodhur Demirin. Si zbrazi të fundit, u ul pér herë të parë. Ishte e qartë se Nazoja nuk kishte si të vinte më. «Po përsë nuk lajmëroi, xhanëm? Po sikur të jetë rrëzuar diku në dëborë?» Kjo e frikësoi. Ç'duhej të bënte tani? Të kthehej në ekip? Po angazhimë që kishin marrë se, sido që të vinte puna, nuk do të humbisnin asnjë plasje? Ai thuajse e kishte bërë gjysmën e punës dhe paga pér atë ditë ishte sigu-

ruar. Megjithatë këmbët nuk i bënин të largohej. Tekniku kishte thënë se pas çdo plasjeje fshihej minerali. Sa bukur do të ishte sikur të dilte mineralin pikërisht pas plasjes së tij! Do ta shikonte mineralin për herë të parë. I kishin treguar se ishte një guri i bukur, i kuqërrremë, me ca vija të zeza. Në sytë e tij ky lloj guri kishte ato çaste shkëlqimin e rubinit. I dukej sikur pas shpërthimit ky lloj minerali do të vërvshonte në galerinë e errët si diçka e zjarrtë, mahnitëse, që do të përpinte qetësinë milionavjë-care të shkëmbinjve të heshtur.

Buzëqeshi përsëri mendueshëm, sepse iu duk sikur fantazoi më shumë se ç'duhej. Këtë pamje diku e kishte parë... me siguri.

Megjithatë shqetësimi për mungesën e shokut vazhdonte ta torturonte si një barominë e mprehtë që gjerryen shkëmbin. Diçka e sëmbonte në zemër. «Po sikur të jetë rrëzuar në gropat e Shesheve të Mëdha?» — mendoi befas. E përfytyroi të zhytur deri në grykë në dëborë, duke thirrur për ndihmë e askush nulk i përgjigjej. Nazoja ishte minator i fortë, po dëbora është e pabesë. Kishte dëgjuar se si njëherë në grykën e Përroit të Gurave dy kuaj u gjendën vetëm në prill, pasi kishte shkrirë dëbora.

Befas i ra ndër mend se motoristi ishte bashkë-fshatar i Nazos dhe ata, kur kishin turnet së bashku, shpesh niseshin bashkë nga fshati. Ky mendim i dha krahë. U nis menjëherë për te sheshi i motokompresorit.

Motoristi ishte brenda dhe në atë kohë po furnizonte serbatorin me naftë. Një fener me xham të nxirë nga bloza lëshonte dritë të zbetë në barakë. Motori i madh heshtte, si ai i sëmuri që kërkon ilaq për t'u ngritur më këmbë.

— Beni, — thirri Demiri pa hyrë akoma brenda, — mos e di se ç'u bë Nazoja?

Tjetri zbrazi pikat e fundit të naftës dhe e hodhi kovën në tokë. Ktheu kokën dhe, apo e pa Demirin të merrte frymë me vështirësi, qeshi lehtë.

— Ke vrapuar, hë? — pyeti dhe i shkeli syrin.

— Ashtu u shqetësova dhe unë. E prita më se një orë mëjë shkëmbit të Bashos mbi fshat. Pastaj i vajta vetë në shtëpi. E di, — shtoi, pasi heshti një sekondë dhe i shtypi djalit majën e hundës, — Nazos i lindi gruaja... Kështu ndodhi... Fare papritur. Seç më tha edhe për ty... Plaça, në i mora vesh një fjalë. Nuk i thonë shaka të të lindë gruaja. Sapo erdha edhe unë. Do vija të të lajmëroja. Nuk pata kohë t'i thosha as teknikut. Ç'thua? — buzëqeshi përsëri dhe i shkeli syrin. — Punon dot vetëm sot?

— Punoj! — u përgjigj Demiri.

— Punon, punon, po t'i shkul veshët tekniku pastaj. Më mirë të lajmërojmë të të vijë ndonjë shok tjetër, si thua?

Djali i ktheu kurrizin dhe u largua. Motoristi u dha te dera e barakës dhe thirri:

— Për çupën e Nazos, hë! Prite, se mbasse e merr për nuse.

Demiri nxitonte. Buzëqeshi kur dëgjoi fjalët e motoristikit, po nuk i ktheu përgjigje.

Në galeri i hoqi takon e drunjë vagonit dhe, para se t'i mbështeste krahët, mori një barominë të vjetër dhe goditi me forcë hekurin e vagonit. Zhurma ushtoi luginave të thella. Ishte shenja për të ndezur motokompresorin.

Mori llambën dhe dy baromina të reja e u sul nëpër galeri. Nuk kishte bërë as njëqind metra, kur ndjeu vërshimin e ajrit nëpër tubacionet e çelikta.

Gjysmë orë më vonë galerinë e mbuloi një pluhur i bardhë, ngjitës, që vishte faqet e saj të lagura. Pistoleta dridhej në duart e tij dhe i shkaktonte një farë korenti në të gjithë trupin.

Përfundoi birat e fundit dhe ato të mesit. U bë qull në djersë. Pluhuri i bardhë i ishte bërë si baltë në fytyrë, saqë i rëndonte edhe qerpikët. E ndiente veten shumë të lodhur. Herë-herë pistoleta zmbrapsej kur haste shtresëzimet e forta të strallave dhe atij i gjëmonte i gjithë trupi. Ndenji të çlodhej ca. Ktheu kokën prapa. Përmes resë së hollë të pluhurit dalloi një dritë të zbetë që mezi ia kapte syri.

«Po gdhihet, — mendoi, — ndërsa unë nuk kam mbaruar birat...»

Pistoleta punonte bosh aty afër këmbëve të tij, duke rrotulluar barominën me kokë të konsumuar. Ndërroi barominën dhe u ngrit më këmbë. Vendosi tubin mbështetës nën pistoletë dhe e drejtoi afër tavanit. Pa me dëshpërim se ishtë i shkurtër dhe nuk arrinte dot. U mérzit së tepërmi. Baromina rrotullohej afër tavanit, pa mundur të gërmonte shkëmbin. U mbështet pas saj me gjithë fuqinë duke u ngritur në majë të këmbëve. Por u lodh shumë më shpejt. E lëshoi pistoletën për tokë fare i pafuqishëm. Mekanizmi shkundej e dridhej me gulçim, sikur ta ftonte njeriun ta rifillonin përsëri luftën me shkëmbin. Duke e parë të kércente kështu në dyshemenë e galerisë, Demirit iu duk si një qenie e gjallë që ankohej për dobësinë e tij. Llambë gati sa nuk fikej dhe ai nxitoi të dilte jashtë. Ai pak karbit që kishte mbetur, ndodhej në hyrje.

Galeria tanë i dukej një vend i mérzitshëm. Nuk të ndihmon askush. Edhe ajo bishëz e vogël që i

hidhej e përdridhej aty nën këmbë, ishte e paaftë pa duart e tij. Vetëm kjo nuk i kishte shkuar kurrë ndër mend. Ta linte punën me aq?!

Drita e mugët e agimit kishte nisur të zgjonte shkëlqimin e dëborës. Të ftohtët ishte bërë i padurueshëm. E ndiente veten të dërrmuar. Tani që kishte bërë aq, nuk mund të mbetej në mes të rrugës. Xha Stefani do të vinte mbas pak të mibushte minat. Atëherë të gjithë do të qeshnin me të. Përfytyronte thuajse qysh tani, se si do ta vështronte tekniku nga koka deri te këmbët dhe do t'i thoshte: «E dija se kështu do të ndodhë... Ti je i vogël akoma, mor djalë!»

Një puhi e lehtë i freskoi faqet. Befas iu kujtua diçka dhe iu afrua vagonit të zbrazur. E çoi në buzë të shinave, ku derdhej sterili, dhe nisi ta mbushte. Kjo ishte një punë tepër rraskapitëse. Vagonin e kishte thuajse mbi kokë dhe lopatën mezi e conte deri në lartësinë e tij. Kjo punë i kushtoi afër gjysmë orë. Pastaj vagonin plot e futi përsëri brenda duke e shtyrë me shumë mundim. Minatorët u japid galerive një farë pjerrësie dhe pikërisht kjo e mundonte tani kaq shumë. E zbrazi në ballë. U krijua një farë lartësie nga mund t'i bënte më mirë birat e tavanit. E ndjeu veten të gëzuar. Pistoletën nuk e kishte të mbyllur, për të mos i dhënë shkas motoristik të dyshonte se ai kishte mbaruar punë me ajrin.

Papritur ndjeu se dikush i preku fort supin. Instinktivisht mbylli dorezën e ajrit dhe zhurma shurdhuese e barominës pushoi. Kur ktheu kokën, pa me habi se pas tij qëndronte Nazoja. I madh në trup, veshur me kominoshe të zeza që kishin filluar të zbardheshin nga të larët e shpeshtë, me kapelën

e meshintë shtrënguar pas kokës deri mbi vetulla,
ai i buzëqeshi djalit si fajtor.

Buzëqeshi edhe Demiri. La pistoletën në një anë
dhe një hov i papritur ngazëllimi e detyroi t'i hidhej
në qafë. Nazoja kishte për të, atë çast, thuajse rën-
dësinë e të atit.

— Të të rrojë! — mezi mundi të thoshte.

— Në dasmë, — tha minatori.

Ai mënjanoi djalin dhe nxori nga xhepi diçka
të mbështjellë me gazetë. Demiri e hapi. Ishte një
copë llokum i shtypur.

— Kështu ndodhi..., — tha edhe një herë Nazoja.

Djali futi në gojë ëmbëlsirën dhe u mat të
merrte përsëri pistoletën. Po minatori e kishte rrëm-
byer më parë...

Në orën gjashtë, kur erdhi xha Stefani, i gjeti
duke punuar akoma. Fytyra e djalit, e bardhë nga
pluhuri, kishte një shprehje të lodhur e njëkohë-
sisht të gëzuar tek shikonte plakun me kërshëri.

Plaku futi shkopin në birat e mesit, shënoi the-
llësinë me gisht dhe pastaj e mati me pëllëmbë.

— Aa, bira të mira paske bërë sot, o Nazo! —
tha duke buzëqeshur. — Një avancim, e ke hallall.

Minatori ngriti sytë nga Demiri dhe i rrahu
shpatullat.

— E kemi nga ky kësaj radhe, o xha Stefan!

Djali buzëqeshi.

Tani ata të tre rrinë në prag të galerisë dhe
numërojnë plasjet e fuqishme që vijnë nga nëntoka.
Fytyra e palarë e Demirit, sytë e mbuluar edhe ata
me pluhur, e gjithë qenia e tij ka marrë një pamje
qetësie burrërore. Nazoja e vështron fshehtas dhe
një admirim i thellë i buron nga sytë.

«Sikur të dalë minerali si rubin!»

BANORET E QYTETIT QE DO TE NGRIHET

Po kthehesha pas pesë vjetësh në ato vise. Autobusi qëndroi para bufe-restorantit. Pasagjerët, edhe unë së bashku me ta, vrapuam të futeshim diku, përti shpëtuar rrebeshit të shiut. Prilli atë vit qëlloi gjithë lagështirë.

Veja aty me një shërbim të shkurtër dhe, të them të drejtën, ky udhëtim më gjëzonte. Arsyja ishte e thjeshtë. Kisha punuar katër vjet me radhë në ato vende dhe mund të takoja shumë të njojur. Fragmentë kujtimesh shtynin pa u ndier kilometrat e rrugës malore. Një libër që kisha hapur të lexoja sapo dolëm nga qyteti, mbeti ashtu, në faqen e parë. Më pëlqeu të shfletoja më mirë librin e kujtimeve dhe gjithçka këtu e gjeja po aq interesante.

Në bar-restorant porosita kafe dhe nga dritarja ndiqja peisazhin e ashpër të asaj qendre kooperative të bashkuar. Pesë vjet më parë ky vend quhej lokalitet, dhe ajo mbaresë «tet» sikur e afronte më afér fjalës qytet. Qysh atëherë, ky lokalitet këmbëngulte në mënyrë të çuditshme t'i afrohej qytetit. Tani, pesë vjet më vonë, natyrisht që kishte me se të mburrej. Ky bar-restorant, për shembull, nuk ndryshonte fare nga baret e qytetit dhe kamerierët venin e vinin të mbytur në punë. Rrugët kishin nisur të bëheshin

më të drejta, me gjithëse në pjerrësinë e shpatit të malit. Nëpër shtylla varesin llamba elektrike të mbuluara me poça xhami për t'u mbrojtur nga shiu, lumi atje më poshtë ishte ngushtuar në një shtrat të betonuar dhe dy brigjet e tij i lidh tani një pasharelë modeste, që nesër do të bëhet një urë e vërtetë me harqe metalike, ku do të kalojnë makinat.

Vazhdonte të binte shi dhe ky peisazh i mybutur në mijegull nuk më sillte aspak trishtim. Në «bar» hynin njerëz të shumtë dhe te secili prej tyre pritja të shihja ndonjë të njojur. Çadrat linin në dyshemenë me pllaka të kuqe rrëke të holla uji. Aty flitin me zë të lartë, kishte mjafit tym duhani dhe ajo që binte më shumë në sy, ishte fakti se njerëzit dukej sikur diçka i preokuponte. Banaku ishte plot. Njerëzit hidhnin ndonjë gotë dhe zhdukeshin përmes shiut.

Po vritja mendjen se ç'duhej të bëja pas kafessë që piva, sepse shiu më pengonte të kryeja gjithë ato punë, kur befas në «bar» hyri Temi. Buzëqesha. Ai nuk më dalloi. Vendosa të mos i flitia derisa të më shikonte vetë, po për pak do ta kisha humbur, sepse edhe ai ktheu një gotë në banak shpejt e shpejt, që shi me dikë dhe bëri për nga dera.

— Temi, — thirra befas me zë të lartë.

Ktheu kokën. Sapo më pa, nxitoi për tek unë. U përqafuam. Biseda jonë nisi ashtu nxitimthi, siç mund të ndodhë midis njerëzish të njojur e që kanë disa vjet pa u takuar. Temi ishte shëndoshur, rinuar dhe në sy kishte atë shprehje mirënjoyeje për jetën, të cilën aty për aty nuk ia kuptova siç duhet. Ai nguli këmbë që unë të pija diçka dhe nuk ia prisha qejfin. E kuptova që nxitonte për diku, sepse rrinte thuajse në cep të karriges. Edhe mua nuk më mbante

vendi. Kisha aq punë, sa më duhej të qëndroja aty, të paktën tri ditë.

Me Temin e lamë të takoheshim përsëri në orën katër. Ai u ngrit e doli më parë se unë. Nga dritarja e pashë që hipi në karrocerinë e një makine, hodhi xhaketën në kokë dhe pas pak më humbi nga sytë.

Më dy e gjysmë në «bar» hëngra një drekë shumë të shijshme dhe, ngaqë nuk kisha ku ta kaloja kohën derisa të vinte Temi, zura tavolinën e mëngjesit dhe vështroja lumin. Shiu kishte pushuar. Diku larg në horizont, tutje nga lindja, dallohej maja konike e Malit të Kudhësit, me një qeleshe të bardhë dëbore mbi krye. Atë ditë m'u kujtuan me hollësi të gjitha ditët e harruara. Krijova përshtypjen se nuk isha larguar asnjëherë së andejmi. Nisa të njihja më shumë njerëz, bile edhe kamerieri, kur më solli kafenë, më vështroi si njeri të afërt.

Temin e pritja me një farë padurimi. Biseda e mëngjesit ishte fare e shkurtër, më tepër një shpërthim miqësie e harruar, ndërsa ajo që më priste tani duhej të zbulonte diçka tjetër, boshllékun e krijuar gjatë vjetve që s'ishim parë. Ne dikur kishim qenë shokë pune, po me atë njeri, më shumë se me të tjerët, më afronte një ngjarje e çuditshme.

Tetë a nëntë vjet më parë Temi jetonte në Tiranë. Ishte mekanik në një uzinë. Sapo qe martuar. Vajza kishte mbaruar gjimnazin. Ishte aq e bukur, sa t'i këputje kokën. Kur qemë njojur mirë së bashku, i thosha Temit me shaka, se ai me siguri kishte përdorur ndonjë gënjeshtër të hollë që kishte mundur t'i merrte mendjen së shoqes. Ai për vete nuk dukej dhe aq i mbajtur dhe këtë e justifikonte me atë që «nga ata të repartit të graso, as që mund të pretendosh më shumë». Pikërisht atëherë kur ai pris-

te të merrte shtëpi, kooperativa bujqësore e fshatit të tij me anë të një letre i bënte thirrje të kthehej në fshat.

Temi në fillim kishte kundërshtuar. Po një ditë ishte kthyer në shtëpi me vendimin e prerë: Do të nisej në fshat. Gjersa e kërkonin me këmbëngulje, arsyetonte thjesht ai, do të thoshte se kishin nevojë për të. Fundja atje ishte rritur e bërë aq.

E shoqja nuk e ndoqi menjëherë pas. Ajo qëndroi ca kohë te prindërit me shpresë se ai do të kthehej përsëri në Tiranë. Atëherë u lindi një fëmijë, që vdiq pa mbushur muajin. Kjo ngjarje sikur i acaroi marrëdhëni midis tyre. Megjithatë Temi nuk luajti nga fshati. Ai punonte në oficinën e kooperativës. Pas një viti vajti edhe e shoqja. Ajo e ndiente veten si mbi gjemba dhe as që pranoi të fillonte punë gjekundi. Në bujqësi jo e jo.

Ato kohë, pikërisht në atë lokalitet, ne filluam ca kërkime gjeologjike dhe fuqinë punëtore na u desh ta siguronimi nga fshati. Megjithëse kooperativa kishte hallet e veta, nuk na la pa ndihmuar. Midis atyre që erdhën të punonin te ne, ishte edhe Temi. Ky djalë, rrëth të tridhjetave atëherë, sepse m'u duk që në fillim shumë i heshtur. U përpoqa ta afroja, por ai sikur më largohej më shumë. Ndiéja se diçka duhej ta brente në shpirt. Bashkëfshatarët e tij nuk më treguan asgjë më tepër nga sa shkrova më lart për të. Megjithëse qendra e ekspeditës sonë ishte gati një orë larg fshatit ku kishte familjen, prapëse-prapë Temi nuk kishte fjetur kurrë te ne. Edhe në mes të dimrit, sa mbaronte turnin e dytë, më njëmbëdhjetë të natës, ai shkonte të flinte në shtëpi.

Ja tani edhe ngjarja që më njohu më mirë me Temin.

Një mëngjes isha ngritur më shpejt se zakonisht. Koha ishte gjithë mjegull. Konturet e maleve, lumi, fshati as që dalloheshin. Me peshqir në krah, zbrita të lahesha në çesmën që buronte në buzë të rrugës. Paksa mbi çesmë kishin vendosur një cisternë të madhe pér naftë. Po na mbaronte karburanti, dhe shqetësimi i parë i atij mëngjesi ishte vonesa e furnizimit. U ktheva te cisterna të vështroja gjendjen, kur befas më panë sytë diçka të çuditshme. Mbështetur pas gurëve ishte vendosur një batanije fëmi-jesh që mbështillte diçka të ngjashme me një boçe rrobash të pastra. Pér një sekondë nuk u besova syve. Megjithatë nxitova të hiqja batanijen dhe të zbuluja se ç'fshihej në të. Një e qarë foshnjeje më turbulloj të tèrin. Mendimi i parë që më lindi, ishte barbarizmi i atij që e kishte braktisur atë aty në mes të rrugës. U zmbrapsa. Foshnja shtrembëroi fytyrën e kuqe, thuajse pa vetulla dhe ia dha edhe një herë të qarit. Atë çast doli nga pas cisternës një plakë e shkurtër, veshur me tumane të zeza, fytyrërrumbullakët, gjithë rrudha, me sy të zinj e të vegjël, të ngulur në sytë e mi, që zgjati duart drejt meje dhe me zë lutës thirri:

— Merre, të kegen nëna, merre!

— Ah! — më shpëtoi befas. Ishte e pamundur të kuptoja se ç'po ndodhë. Megjithatë e rrëmbeva foshnjen më duar. Kisha përshtypjen torturuese se aty duhej të ishte plevitosur, i mbështetur pas gurëve të ftohtë. E mbështolla mirë me batanije dhe fillova ta tundja nëpër duar pér ta pushuar së qari.

— Faleminderit, bir! — tha plaka.

E drejta është se ajo plakë nuk më la asnjë shenjë respekti. Isha shumë i revoltuar. E vështrova ashpër. Të ishtë ajo vallë dëshmitare e asaj brak-

tisjeje dhe të kishte qëndruar aq indiferente, deri në çastin kur duhej të vija unë ose dikush tjetër?!

Gjithçka u sqarua pas disa minutash. Plaka ishte nëna e Temit dhe fëmija djali i tij, që kishte lindur një natë më parë. Plaka besonte se, që ta shpëtonte këtë fëmijë nga fati i të parit, duhej të improvizonte pikërisht skenën, sikur fati e sillte këtë fëmijë jo nga barku i nënës, po nga rruga e madhe. Në të tilla raste, ai që gjente fëmijën në rrugë, bëhej kumbar. Dhe plaka, pa dijeninë e lehonës, e kishte mbësh-tjellë foshnjën mirë, kishte bërë me të afër një orë rrugë, thuajse që pa gdhirë, dhe e kishte sjellë deri në prag të ekspeditës sonë, ku lëvizjet e njerëzve në mëngjes ishin të shumta. Kjo i jepte mundësinë që fëmijën ta gjenin më shpejt se kudo gjetkë.

Plaka pastaj më pyeti me hollësi për familjen. Kur mori vesh se ne ishim shtatë vëllezër dhe që të gjithë të rritur, sytë i shkëlqyen nga gjëzimi, se, sipas saj, nëna ime kishte pasur bark të mbarë dhe ky fakt lidhej shumë me mbarësinë e foshnjës që mbajta në duar.

Temin e takuam rrugës. Mbeti një çast i hutuar. Siç më tha më vonë, zakoni i fshatit nuk e lejonte ta shikonte tri ditë me rradhë fëmijën e sapolindur. Befas u skuq deri në rrënje të flokëve, sepse e mori me mend ç'mund të kishte ndodhur. Më vështroi drejt në sy, sikur të më kërkonte ndjesë dhe për një sekondë qëndroi para plakës shumë i zemëruar.

— Të të rrojë! — urova unë duke buzëqeshur.

E gjithë kjo ngjarje nuk zgjati më shumë se dy-tri orë. Lehona, kur mbërritëm ne në shtëpi, flinte e këputur nga dhembjet e lindjes. Plaka vuri tiganin të bënte petulla.

Kjo ishte vizita ime e parë në shtëpinë e Temit.

Sado që ai u pérpoq tē krijonte një farë humori, prapëserapë diçka nuk shkonte. E shikoja tē shqetësuar. Pimë raki me gjizë dhe hudhra tē njoma, copëtuam një pulë tē pjekur, por asgjë nuk po na shijonte. Qëndrova aty disa orë. Hynin e dilnin njerëz. Gratë pëshpëritnin me zë tē ulët.

Fëmija qante herë pas here në dhomën tjetër. Temi hiqej shumë mospërfillës pér tē gjitha këto. E shikoja në bisedë. Lindja e fëmijës, së bashku me gëzimin, me sa mundohesha ta kuptoja, i sillte një varg preokupimesh që kishin tē bënин me diçka tē pakapshme atëherë pér mua.

Pas disa ditësh vajta përsëri në shtëpinë e tyre. Zjarri bulonte në vatër. Kuzhina ishte e pastër. Atë darkë u njoha edhe me gruan e tij.

— Faleminderit, — tha ajo. — Këtu në fshat ka ca zakone tē tilla që..., — dhe vështroi tē shoqin.

— Gjithçka u bë pa dijeninë tonë...

Akuza binte mbi plakén. Përpjekja e së resë pér t'u shfajësuar nuk më pëlqeu. Nuk iu përgjigja. Fytyra e Temit mbeti e pandryshuar. E kuptova se ajo akoma e ndiente veten në një ambient fare tē huaj. Ajo e quante këtë një farë fatkeqësie.

Na shtruuan rakinë. Ajo i kafshoi buzën Temit, kur ai e zhubbaviti pecetën e hekurosur dhe e hodhi midis këmbëve tē kryqëzuara. Ai bëri një lëvizje moskokëcarëse me dorë. Kjo mjaftoi që ta ndieja veten shumë ngushtë. Besova se gruaja e Temit, pikërisht atë ditë që i kisha vajtur unë pér vizitë (një mysafir qyteti, siç mendonte ajo) përpiquej tē vendoste në shtëpi rregulla tē reja. Dhe sipas saj fatkeqësia ishte se, duke filluar nga vetë Temi, që zhubbaviti pecetën kaq pa edukatë, këtu nuk e kuptonte askush.

— Në fshat është e vështirë të mbash shtëpi si në qytet, — tha pas pak ajo duke i vënë zjarrit një dru. — Të tilla janë konditat... kur nuk e ke çësmën brenda...

— Kurse unë mendoja ndryshe..., — i kundër-shtova për herë të parë.

Ajo më vështroi sikur nuk më kuptoi se ç'de-sha të shtoja, por, kur e ndjeu se nuk e zgjata më, e ndërroi temën e bisedës.

— Do të keni shumë punë akoma këtej?

— Shpesh kjo nuk është në dorën tonë, — iu përgjigja. — Ne mund të rrimë akoma edhe dy vjet, siç mund të rrimë edhe dy muaj.

— Kur të largoheni, do t'i merrni njerëzit me vete?

Nuk e kuptova se ç'donte të thoshte. Ngrita kō-kën ta vështroja.

— Njerëzit?

— Punëtorët! — shtoi ajo.

— Natyrisht, ata që do të pranojnë, — thashë.

— Mbase nuk do të keni kundërshtim të merrni edhe Temin, — shtoi ajo. — Është e vetmja mënyrë për t'u larguar nga fshati.

Vështrova i shqetësuar Temin. Ai ktheu gotën e rakisë që kishte përparrë dhe iu drejtua së shoqes:

— Vetëm këtë nuk duhej ta thoshe. Mjaft më! — ngriti zërin ai. — Duhet të bindesh njëherë e mirë, se unë këtu... pikërisht këtu në fshat u rrita dhe u bëra aq i mirë dhe i dashur, sa të fitova zemrën. Kuptove?

Vetullat iu bashkuan dhe dy rrudha të lehta i mbinë mbi ballë. Ai mbushi përsëri gotat dhe e ngriti të tijën ta trokiste me mua.

— Ngadalë, — ia preva unë, — nuk kemi aspak ndër mend të dehemë.

— Ti mos u mërzit, — i tha ajo të shoqit. Toni i saj befas u bë më i butë. — A më kupton? Unë këtu e kam të vështirë të jetoj. Jo sepse më mungojnë bulevardet, po nuk jam e zonja të ndaloj një lloj jetese të mbushur me paragjykime e zakone, të cilat, megjithëse nuk më pëlqejnë, çuditërisht depërtojnë deri tek unë që jam vajzë qyteti.

— Duhej të ndodhte e kundërtë, — tha ai. — Kjo është dobësi...

Ajo heshti.

Ne diskutuam shumë atë natë.

Dy ditë më vonë Temi më paralajmëroi, në bazë të rregullit, se pas pesëmbëdhjetë ditësh kërkonte të largohej nga ne. Do të punonte përsëri në oficinën e kooperativës.

— Po afron pranvera, — tha ai kokulur. — Fshati ka shumë punë...

...Të gjitha këto kishin ndodhur pesë vjet më parë. Me Temin nuk më ishte dhënë rasti të takohesha më.

Ai erdhi më katër e gjysmë. Më kërkoi ndjesë që u vonua më tepër se ç'duhej dhe porositi një kafe për vete. Disa minuta më vonë më ftoi ta kalonim atë darkë së bashku në shtëpinë e tij. Kjo ftesë më la në shpirt një ndjenjë të trubullt. Ishte thuajse një shqetësim. Pesë vjet më parë e shoqja më ishte lutur të bëja diçka për Temin dhe unë as që isha përpjekur. Nuk më vriste aspak ndërgjegjja...

Rugë ishte gjithë baltë. U përpoqa të ruaja këpucët, po ishte e pamundur. Që rrugës mësova se

plaka kishte vdekur ca kohë më parë. Temit i kishte lindur edhe një vajzë. Ai më tregoi shumë pak përvete. Biseduam për gjëra të tjera. Nuk kishin mjaf-tuar dy vjet që punova me të për ta njojur si atë ditë. Nuk di gjithashtu në mund t'i quaj frysëzim ato pak fjalë që tha ai kur u ndodhëm në këmbët e një kodre gjithë gjelbërim, duke vështruar fushën e vogël që përfundonte buzë lumit.

— Sikur qyteti të ngrihej në atë luginë! — tha befas ai, duke treguar një copëz të fushës që futej si pykë midis kodrave.

— C'qytet? — pyeti i habitur.

— Këtu do të ngrihet me siguri një qytet..., — tha ai. — Nuk mund të vazhdohet kështu. Këto dhjetë copë fshatra me 30-40 shtëpi secili, edhe ato larg e larg njera-tjetrës... E kuption? Unë përfytyroj një bulevard, pikërisht në buzë të lumit... Tani që shtrati është betonuar... Kësaj i thonë që fshatrat së shpejti duhet të bëjnë këmbë dhe t'i afrohen njëri-tjetrit. Mjaft kanë qëndruar majë këtyre kodrave, të vetmuara.

Ai fliste sikur ta kishte gjithçka para sysh. Gjithë rrugës ne u preokupuan për urbanistikën e qytetit të ardhshëm. Temi, edhe kur u ngjitim majë kodrës, ktheu kokën e vështronte luginën ku kishte projektuar qytetin e ri.

Në shtëpi nuk gjetëm njeri. E shoqja nuk ishte kthyer akoma nga fusha, ndërsa fëmijët ishin në kopsht.

Ai u vu të bënte kafe dhe përshtypja ime e parë ishte shumë e këndshme. Këtu nuk ndryshonte asnjë nga shtëpia ime në qytet. Kuzhina ku hymë ne, i ngjante një dhome të vogël pritjeje. Nuk do të

mundohem ta përshkruaj këtë dhomë, sepse ajo u ngjante aq shumë mijérave të tilla në të gjitha apartementet e qyteteve.

Në orën pesë e gjysmë erdhi gruaja e Temit me fëmijët për dore. U takuam përzemërsisht. Më erdhi mirë që duart e saj ishin ashpëruar. Djali i Temit ishte një fëmijë i shëndetshëm, veshur me pantallona të shkurtra pikërisht atëherë kur unë nuk kisha hequr ende as pardesynë.

— Ej, Cisterno! — i foli Temi, duke e tërhequr pas vetes. — E njeh xhaxhin, hë?

«Ç' emër i çuditshëm», — mendova. Po kjo ishte vetëm një shaka e Temit. Në të vërtetë djalin e quanin Altin, por ai e thërriste me shaka cisterno, në kujtim të vendit ku e kisha gjetur unë.

— Nuk do ta harroj kurrë atë ditë, — më tha.
— Si kur të mos ishe ti, kushedi ç'mund t'i thosha së ndjerës nënë. Ajo ngjarje u bë për shtëpinë tonë shkak i një grindjeje të heshtur. Duhej të lindte vajza që ta harronim. Qysh atëherë i thirra kështu djalit. Ndoshata kur të rritet, do ta harrojë këtë emër të dytë, por unë do të doja që ta kujtonte... janë ca gjëra që nuk duhen harruar. Më kupton?

Ndërkohë e shoqja kishte dalë nga kuzhina. Si tha këto fjalë, Temi më kërkoi leje të shkonte përtë ndihmuar gruan.

Luajta me fëmijët. Vajzën e mora në prehër, ndërsa «Cisternoja» m'u afrua dhe më kapi dorën. Duke u zhytur në fantazinë e Temit, e përfytyroja djalin duke shëtitur në bulevardin buzë lumit...

Fëmijët fjetën shpejt, ndërsa ne qëndruam deri vonë. Më vinte mirë tek mendoja sa shumë kishte ndryshuar e shoqja e Temit, me ato duar të ashpra.

që vinin erë qumëshët të ngrohtë. Më vinte mirë kur
vura re që ajo e ndiente veten si dikur në shtëpinë
e saj në qytet dhe kur e dëgjoja të fliste e të fliste
pa pushim e tërë gjallëri për qytetin që do të lindte
buzë lumit...

JETA NË KËNETË

Po perëndonte hëna, dhe uji, sa vinte, po i humbiste vijëzimet e verdha mbi kreshtat e valëve. Buzë kanalit po digjej një grusht zjarr. Dita që po lindte, kthjellonte ngadalë një qiell ngjyrë hiri, parë, që përkulej mbi pasqyrën akoma të errët të kënetës. Në horizont dallohej brezi i zi i pyllit. U zgjua uji dhe qetësia blu u drodh nga puhia e tramundanës. Hijet rrreth zjarrit u tulaten më shumë pranë njëratjetrës. Njëra prej tyre, pastaj, u zgjat dhe shtyu me këmbë një copë urë zjarri të përflakur. Mbi ajrin e ftohtë u ngrit një tym i hollë prushi të shuar që e përpjui kaltërsia që po lindte. Zjarri sikur u gjallërua më shumë.

— Shko tani! — tha roja, duke çmpirë krahët
— Te Dili po djegin kazanin e fundit. Shko... dhe ngrohu atje. Dy gota raki do të të sjellin më vete... E, ç'thua, Sokrat?

Lypsari as që lëvizi nga vendi.

Hëna futi kokën nën kreshtën e stërgjatur të gadishullit, që i ngjante tani një kafshe vigane më kokën nën ujë.

— Pres të vijnë peshkatarët, — tha Sokrati dhe mblođhi më pranë vetes një rrobë të shqyer në disa vende, të cilën ishte e vështirë ta dalloje se ç'ngjyrë

kishte pasur kur kishte qenë e re. Më shumë i ngjante një velenxe të bardhë me push të rënë prej kohësh, ku ishin bërë dy vrima të mëdha për të futur krahët. Fytyra e lypstarit ishte e vogël, me mjekër të mprehtë e sy të thellë në gri. — Unë e di mirë se ti... Sot diç ka për të ndodhur. Nuk pres të më japid cironj si përdita. Jo. Pres të më thérresin edhe mua për ndihmë.

Roja plak i godinës së Të pestës qeshi nën hundë.

— Asgjë nuk ka për të ndodhur! Dëgjomë mua, mor i mjerë. Shko te Dili. Shko të ngrohesh. Atje copëtohen trungje ulliri nën flakët që ngrohin bërsitë. Shko... mjaft ndenje këtu me mua. Hapt, tanj vjen zoti Riko dhe dua t'i bëj kafenë. Shko!

Lypstar mblohdhi bishtat e shkurtër të druve të padjegur dhe i hodhi mbi prush. U fryu dy-tri herë, po tymi i dogji sytë dhe ai pështyu në zjarr.

— Zoti Riko..., — tha nëpër dhëmbë Sokrati. — Nuk më ka dhënë kurrë dy qindarka. Zoti e ndjeftë! Burrë më të shëmtuar nuk më kanë zënë sytë. Zoti Riko... sot... megjithatë e ka pisk.

Befas sytë e lypstarit shndritën fort. U skuq edhe lindja. Mbi gadishull ranë fijet e para të rrzeve të diellit. Këneta shndriti si peshk i veshur në ar gjend.

— I pari..., — murmuriti lypstar, — e shikon?

Roja ktheu kokën dhe dalloi të afrohej pranë tyre një figurë njeriu që e cte buzë kanalit i përkulur nën peshën e rëndë të rrjetave. Kokën ia mbulonte një kapuç ngjyrëkafë dhe sytë i lotonin nga era e ftohtë. Figura e peshkatarit u pasqyrua mbi ujë dhe rrjetat, rrobat e bardha, këmbët e zbathura, u veshën me diell.

— Mirëmëngjesi, Sokrat... mirëmëngjesi, roje!

— tha peshkatari dhe hodhi përtokë rrjetat dhe fushqerën.

— Mirëmëngjesi, djalë! — iu përgjigj Sokrati.

— A i ke mprehur dhëmbët pér sot?

— Dhëmbët?

— Po. Dhëmbët e fushqerës...

— Përsëri me avazin e djeshëm, — tha peshkatari. — Dhe ti, roje, besoj se do të rrish urtë sot. Tani vjen Fani dhe mos e bëj dy me të. Hap postbllokun!

— Zoti Riko nuk ju lejon të peshkoni me fushqera, — tha roja duke kruajtur kokën. Sytë i uli përtokë.

— Zoti Riko nuk ka të bëjë me ne. E ç'do ai? Të pestën ia japim. Në fund të fundit, këneta nuk është e tij.

— Nëm një cigare, djalo... — tha Sokrati. — Të tijat janë të gjitha... Kupton, djalo? Të tijat... Ka rrezik që edhe ne të tijët duhet të jemi...

— Pusho! — bërtiti roja, duke iu hakërryer lypsarit. — Merr vesh edhe ti nga këto punë!

— Ti dhe zoti Riko që merrni vesh, — tha peshkatari, — na tregoni së paku urdhrin... Peshq të helmuar! Edhe mund të ketë ndodhur, xhanëm! Po ne nuk ia japim zotit Riko peshqit e zënë me fushqerë. Do t'i mbajmë pér vete... Le të helmohen fëmijët tanë...

— Ndoshtha nis që këtu..., — belbëzoi papritmas lypsari duke parë fytyrën e skuqur të peshkatarit. — Dhjetë vjet më parë diç ndodhi. Mbase 1934-a i ngjan 24-ës!

— Qelbësirë! — shau roja dhe u përkul të merrte nga zgjarri që po shuhej, një copë urë të ndezur pér të qëlluar Sokratin.

— Mbaј dorën! — thirri sa kishte në kokë peshkatari i ri. Nuk ishte më shumë se njëzet e pesë vjeç. Kishte fytyrë të gjatë, të imtë e nën kapuçin ngjyrëkafë i dalloheshin dy fije floku të kuqërrreme.

Roja lëshoi urën përsëri mbi hi. Sokrati mbësh-tolli krahët me njëri-tjetrin.

— Petro, — i foli peshkatarit, — mbaј Fanin me vete. Ishallah vjen, pa e sjellë kokën zoti Riko. Është egërsuar shumë. E pse jo, mund të sjellë edhe xhandarët.

Peshkatar tundi kokën, Nga këneta frynte po ajo erë e ftohtë tramundane që valézonte sipërfaqen e ujit. Balta blu, e çarë kryq e tërthor, po thithë ujët e kripur që vërvshonte në drejtim të fshatit. Dita ishte e kthjellët. Midis ujit dhe rërës, shtëpitë e ngjeshura pas njëra-tjetrës përballonin sulmin e erës dhe të ujit. Një velë e bardhë, fare e vetmuar, u zhduk në bisht të gadishullit.

Peshkatar i dytë erdhi dhjetë minuta më vonë. Në sup mbante edhe ai fushqerën. Tehu i saj i dhëmbëzuar ishte i pastruar pér bukuri. Bishti i saj i gjatë ishte i lëmuar. Fani vetëm sa tundi kokën.

— Pse akoma këtu? — i tha më të riut.

— Ja... tani, — u përgjigj Petroja.

— Daleni, — tha roja, duke iu drejtuar Fanit.

— Daleni, sa të vijë zoti Riko e merruni vesh me të... Mos më merrni më qafë!

Në këto e sipër mbërriti sipërmarrësi, një burrë i shkurtër e i hollë, me sy jeshilë e vetulla të zeza. Flokët e thinjur i kishin mbuluar veshët. Borsalina e re fringo, me strëhë të gjerë, i shkurtonte çuditërisht tepër fytyrën.

— Ej, trima..., — tha ai në vend të përshëndet-

jes, — përsëri me këto të mallëkuara fushqera? Na helmuat popullin. Nuk dëgjoni ju, xhanëm?

— Do t'i hamë për vete peshqit..., — tha Petroja.

— Nuk t'i japim ty!

— Piciruk, mos të ha kurrizi? Unë marr të pestën nga peshqit tuaj dhe nuk do të të pyes ty se ç'do të jetë imja... Dëgjove? — dhe vajti t'i trokiste në kokë me gishtin e mbledhur.

Petroja u zmbraps një hap. Fani rrëmbeu rrjetat dhe u drejtua për nga kanali ku qenë rreshtuar lundrat. I riu e ndoqi nga pas me dy fushqerat nëpër duar.

Postblloku ishte një tra i hollë, që myllte të dyja anët e kanalit. Çelësin e mbante roja.

— Eja hape! — i bërtiti Fani.

Zoti Riko qeshi me ironi.

Hapeni, de! Merrini lundrat në kurriz dhe karoni...

— Këneta nuk është jotja, — tha peshkatari i vjetër. — Ti, zoti Riko, ke blerë dajlanin dhe jo kënetën. Nuk ta kam thënë kurrë këtë, po sot më detyrove. Këneta është jona. Ne të japim të pestën. Ç'do më tepër? Mos do të na katandisësh të gjithë lypsarë si Sokrati?

— Unë kam blerë nga shteti dajlanin edhe kënetën, — tha zoti Riko. — Më jepni të pestën?! Nuk ma jepni ju, por juas marr unë. Dhe, kur nuk dua unë, ju nuk mund të peshkon. Ngarkoni lundrat dhe çojini në det. Deti është juaji.

Sytë e peshkatarit lëshuan xixa.

— Hajde, Petro! — bërtiti sa kishte në kokë. — Mbësë na merr lundra në kurriz.

Roja u drithërua. Sokrati i shkeli syrin. Zoti Riko zhyti duart në xhepat e pantallonave dhe filloi

të tundte këmbët. Peshkatarët radhitën rrjetat në fund të lundrës, lanë torbat në pllorë dhe e afruan lundrën afër postbllokut. Ndërkohë, në buzë të kanalit po vinin peshkatarët e tjerë..

U dëgjuan thirrma:

— Kthehu, Petro!

— Zoti Riko... na lejoni të peshkojmë. Jemi fukarenj!

— Kjo nuk durohet!

— Duam të rrojmë!

— Hipni, djema!

Një tufë fushqerash u kryqëzuan mbi kokën e sipërmarrësit, si heshtat në betejë. Pastaj ai copë qìell u kthjellua. Roja se nga ishte zhdukur. Kérkonin çelësin e postbllokut. Dhe befas, njëzet duar e shtynë lundrën e Fanit drejt kadronit të postbllokut. Trari u thye më dysh. Lundra e parë u shkëput nga grumbulli dhe eci drejt kënetës...

Britmat sa vinin dhe shuheshin. Petroja kthou kokën prapa. Pas tij, si shigjeta të holla, vinin me radhë lundrat e vogla, të lyera nga jashtë me katran.

Në kënetën e madhe lundrat-shigjetëza u shpërndanë nga të katër anët. Petroja qëndroi në fund. Lundra ishte gdhendur nga një trung lisi dhe anët e holluara tanë kishin nisur të plasariteshin. Mbi pllorë ishtë ulur Fani. Ai dridhët një cigare të trashë dhe mendohej. Fytyra e zeshkët, me rrudha të trasha që i thelloheshin në faqe, i ishte skuqur nga thëllimi. Xhaketa e shkurtër i shtrëngonte trupin. Lëpiu letrën, pështyu copat e këputura me dhëmbë dhe ngriti kokën. Një peshk i madh u hodh befas në krah të lundrës, u shtrembërua në mes nga forca dhe u zhduk përsëri në ujë.

— Këtu! — tha Fani.

Petroja ndali lundrën. Nxituan të shpleksnin mbrezhat. Midis rrjetave, vende-vende kishin mbe-tur myshqe të gjelbra dhe leshterikë bojëkafë. Ata ngulën hurin e parë të mbrezhës në buzë të lundrës dhe ecën më tej...

Kishte kaluar mesdita. Fani shkundi duart dhe futi në torbë copën e bukës së misërt. Petroja e shikonte drejt në sy. Nofullat e fuqishme pushuan së përtypuri.

— Ej, — tha ai, kur ndeshi me vështrimin e më të riut, — ç'më shikon? Mbarë, ë?

— Po, — u përgjigj djali. — Dy kuintalë. Nuk janë pak.

— Një e gjysmë — tha Fani. — Gjysma është e zotit Riko.

— Po sikur të mos ia japim?

Fani qeshi.

— Do t'ia japimi, — tha ai. — Nuk grindemi me qeverinë.

— Pse, ai është qeveria?

— Të qeverisë janë si ai.

Djali nxori gjuhën. Pastaj tha:

— Si thua ti, xhaxha, përsë të na ndalojë të peshkojmë me fushqera? Të jetë helmuar vërtet njeri, vallë?

— Nuk e di, — tha peshkatari i vjetër. — Ai ka blerë dajlanin dhe këto dy kuintalë peshk nuk do të bien në rrjetat e tij. Fushqera është vetëm se-bepi, për të mos na lënë të peshkojmë. Tani është koha kur peshku lë kënetën dhe i duhet të kalojë në det... E kuption? Ujërat janë ftohur shumë, kurse

deti është i ngrohtë. Në këtë stinë ka më shumë punë dajlani i tij.

— Po kjo puna e së pestës? — vazhdoi të pyeste i riu. — Një e pesta nuk është pak. Deri kur do të na e marrë ai?

— Kështu ka mbetur, — u përgjigj Fani. — Unë kështu e kam gjetur nga im atë. Tregojnë se të pestën e merrnin qysh në kohë të Turqisë.

— Po rrjetat, fushqerat, lundrat, krahët janë tonat, — u hodh Petroja.

— Po këneta?

— E askujt dhe e të gjithëve...

— Është e shtetit, — tha Fani. — Ne paguajmë një lloj takse.

— Po taksën e merr zoti Riko, ama! Po si? Duke dredhur zinxhirin...

Fani heshti. Mori shkopin e gjatë dhe e nguli në mes të ujit. I mbështeti krahët dhe lundra lëvizi. Pështyu bishtin e cigares dhe ngriti sytë në horizont. Midis ujërave të gjelbra dallohej një kryq i vëtmuar. Lundra eci drejt kryqit. Sa herë që peshkimi i shkonte mbarë, Fani vente dhe e puthte atë kryq të vëtmuar. Ishte varri i zbrazur i babait të tij, mbytur ndonja njëzet vjet më parë. Mbi shtyllën horizontale të kryqit shpesh qëndronin për pushim pulëbardhat dhe çafkat qafëgjata. Petroja preku kryqin me dorë dhe hoqi kokoren. Në ballin e djersitur të të riut ishin ngjitur flokët e kuqërremë. Fytyra pikaloshe sikur iu mpi. Fani pshëretiu.

— Ndjesë pastë! — murmuriti.

Rreth kryqit mbështilleshin çdo vit fije leshterikësh dhe trungjet sfiliteshin nga kripa. Atje ishte vendi më i thellë i kënetës. I mbyturi mbahej mend si njeri i mirë dhe peshkatar i zoti. Prandaj pesh-

katarët, sa herë u takonte rasti të kalonin andej, i kalonin kryqit pranë dhe e preknin me dorë. Pastaj lagnin buzët me ujë të kripur. Lundrat vërtiteshin ngadalë, bënин një rrötullim të plotë dhe niseshin pastaj drejt jugut. Ky ishte një lloj pelegrinazhi i çuditshëm. Fanin e shikonin të gjithë me respekt. Ky burrë ishte gjallë i ati!

— Ndjesë pastë! — murmuriti edhe një herë. Zgjati dorën dhe preku kryqin. Lundra u afrua nga dalë së gjeri. Buzët e peshkatarit u mbështetën mbi drurin e sfilitur, të rrähur nga shqotat.

Filluan të mblidheshin lundrat. Ishte ajo orë e pasdites, kur dielli donte akoma edhe dy fushqera të prekte kurrizin e gadishullit. U hoqën kokoret nga flokët e djersitur. Nga mesi i një lundre u ulën velat. Mbi pllorën e saj hipi një burrë trupmadh, gjoksgjerë, veshur me një triko leshi jeshile. Vështrimi i tij i përpriu horizontet, pastaj erdh e u ngul mbi fytyrën e Fanit.

— Dëgjo, or mik. Edhe unë e kam njojur tët atë dhe e mbaj mend mirë që nuk e kishte thyer shpinën kurrë. Sot të pamë edhe ty të na çash rru-gën. Na vaftë mbarë dhe gishtat tanë mos u ndafshin kurrë nga grushti. Kam tre kuintalë peshk në lundër dhe dhjetë ditë me radhë mund të mos kem asnjë cirua. Fati i fëmijëve në dorë të ujérave. Të pestën do ta dorëzoj, por jo ama të më ndjekin nga këneta si një qen... Ndjesë pastë! — dhe tregoi kryqin e madh. — Këtu lindi dhe këtu i la eshtrat... Këtu do t'i lija edhe unë, po të ishte se do të ma pritnin bukën e kalamajve.

Burri pushoi befas, zgjati dorën në ujë, e mbushi dhe piu nga këneta e kripur. Plakosi një heshtje

— e gjatë. Dikush u kollit, dhe nga pas kurrizit të Fanit një djalë tha:

— Këneta është e madhe, mor shokë, dhe ne mund t'i nxjerrim lundrat tona ku të duam. Na kanë vënë një postbllok dhe na duket sikur na i kanë zënë të gjitha shtigjet. Si puna e budallait! Zoti Riko le të na presë në kanal dhe ne i dalim në Shënthanas.

— Jo, — tha Fani me zë të lartë. — Nuk jemi aspak budallenj. Unë do të kaloj nga kanali. Nuk kam ndër mend të rroj me frikë gjithë jetën. Ti, Petro, ç'thua?

— Unë do të vij pas teje, xhaxha, — tha djali.

— Zoti Riko është një dhe nuk ka ç'të na bëjë!

— Zoti Riko mund të ketë thirrur xhandarët, — tha peshkatari që kishte treguar rrugën e Shënthanasit.

— Nuk e besoj! — tha dikush. — Kështu kërcënoi edhe dje.

— Sidoqoftë unë do të kaloj nga kanali, — tha Fani. — Të pestën le ta marrë. Po fushqerën nuk ma heq dot nga duart.

— Të heq kënetën, — tha përsëri djali i ri.

— Kur të shohë majën e veshit! — tha burri trupmadh. — Unë them ta bisedojmë këtë punë dhe me djemtë e dajlanit. Po na kuptuan edhe ata, le të dalë të peshkojë vetë zoti Riko.

— Ata i ka rrrogëtarë, — tha Petroja.

— Akoma më mirë, — ia ktheu Fani. — Ata janë shokët tanë.

— Po kjo është grevë, — tha një peshkatar i shkurtër me mjekër të shtrembër.

— Unë nuk e di se si janë grevat, — tha Fani.

— Kam dëgjuar se bëhen greva, po nuk e di si janë.

E, në qofshin si këto që po bëjmë ne, le të bëjë e gjithë bota!

— Po sikur të mos i japim as të pestën, xhaxha? — pyeti përsëri Petroja.

— Jo, — tha ashpër ai. — Atë le ta marrë. Unë dua që të më lërë të qetë në punën time.

— Ndoshta nuk e ka gabim, — tha edhe një djale-tjetër. — Kur ai na trajton kështu, edhe ne duhet t'i flasimi me një gjuhë tjeter.

Mbi gadishull u shfaq një grumbull madhështor resh të rrumbullakëta. Rreth e rrotull, tej në horizont, toka kontinentale dukej si e nemitur. Vetëm uji belbëzonte. Brigjet ngriheshin dhe uleshin nën një kaltëri të përgjakur nga rrezet e fundit të diellit. Hapën velat e bardha dhe u nisën. Kurrë nuk kishin ecur aq pranë njëri-tjetrit. Rripi i ujit që futej në kanal, dukej së largu si një teh i mprehtë shpate.

Lundra e parë qëndroi në hyrje të kanalit. Një figurë asimetrike, e leckosur, me flokët e gjatë që ia rrëmbente era, u ngrit befas nga balta dhe u mundua të qëndronte më këmbë. Fani njohu Sokratin.

— Eeej... Eeej... xhandarët... xhandarët! — thirri sa kishte në kokë lysari. Një dorë e tij u zhyt në ujë. Iu shtrembëruan këmbët dhe për pak do të ishte rrëzuar në ujin e kripur, sikur Fani të mos i kishte zgjatur shkopin e gjatë. Ai u kap pas shkopit, u zhyt deri në mes në ujë e baltë dhe u zvarit deri në lundër. Dridhej. Kishte katër orë që priste aty. Buzët i ishin mavijosur. Sytë i kishte më të mëdhenj se kurrë.

Lundrat u grumbulluan përsëri. Sokrati nisi të tregonte se zoti Riko priste në fund të kanalit, i shoqëruar nga një togë xhandarësh. Në drekë ia kishin shtruar me koce të pjekura dhe verë të kuqe.

Postblloku ishte i hapur. Fani qëndroi pranë bregut dhe i thirri rojes:

— Eja të marrësh të pestën.

Por, në vend të rojes, nga godina e vjetër dolën shtatë xendarë me armët nëpër duar. Ata ia behën buzë ujtit dhe sytë e tyre u ngulën në fundin e lundrës.

— Hajde, qerrata! — tha njëri prej tyre, duke qeshur me ironi në drejtëm të Fanit. — Peshk të mirë paske zënë sot! Dorëzoje!

— Le të vijnë ta marrin, — tha Fani. — Nuk ka nevojë pér xendarë, kur është fjala pér të pestën.

Zoti Riko doli nga dera dhe u dha në buzë të kanalit.

— Anarhist! — i bërtiti ai Fanit, duke i tundur gishtin. — Ke peshkuar pa leje dhe nuk ke të drejtë të marrësh asnjë gjuhëz.

Petroja i nguli sytë peshkatarit të vjetër. Fytyna e tij e palarë, me njolla balte gri u zverdh.

— Të thashë, xhaxha! — foli djali.

— Peshku është djersa ime dhe atë nuk ma merr njeri! — iu përgjigj Fani.

— Xendarët qeshën me të madhe.

— Trim! — tha njëri. — Ligjin nuk e shkel askush!

Në këto e sipër tre prej tyre hipën në lundër.

— Mos! — bërtiti Petroja sa kishte në kokë. — Mos prekni gjë, se do ta keni keq!

Fani u fut midis tyre.

— Zoti xendar..., — dhe diç donte të thoshte, por një kondak pushke e përmbysi befas mbi anët e holluara të lundrës dhe koka e tij preku ujin. Petroja rrëmbeu fushqerën. Nga lundra që po vinte

pas, u dëgjuan britma. Fani u ngrit rrëmbimthi dhe kërceu mbi pllorë. Zgjati dorën dhe kapi edhe ai fushqerën. Të tre xhandarët u rrethuan tani nga dhjetë dhëmbë metalikë të mprehur. Ata që ishin në breg, ngrinë për një çast. Pastaj njëri prej xhandarëve ngriti me shpejtësi pushkën dhe, me sa fuqi pati, e drejtoi mbi kokën e Fanit. Peshkatari i vjetër iu shmang goditjes dhe, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, dhëmbët e mprehtë të fushqerës u ngulën në barkun e xhandarit. Pikërisht atë çast, nga bregu u zbrazën njëherësh dy gryka pushkësh. Trupi i peshkatarit u lëkund, u drejtua, ktheu sytë nga Pe-troja dhe ra i gjakosur mbi lundër me vështrim të ngulur nga djali...

Të gjitha këto ndodhën brenda disa minutash. Djali i ri, duke parë trupin e përgjakur të Fanit që skuqte luspat e peshqve, rënkonte i mbërthyer nga duart e fuqishme të shokëve. Sytë iu mbushën me gjak. Ngriti kokën nga Fani dhe vështrimi i tij, më i mprehtë se dhëmbët e fushqerës, u mbërthyen mbi zotin Riko që po dridhej.

— Do të na i paguani me kokë! — tha, duke rënkuar.

Ra mbrëmja. Një mbrëmje e butë, e pistë, që priste gjëmime. Retë mbi gadishull u stërgjatën dhe pushtuan qiellin. U errësua aq tepër, sa dukej sikur plumbi i qiellit të ishte shkrirë në ajër. Pastaj vëtëtiu. Rrufeja skuqi natën, hapi brazdat e zeza dhe la një njollë të kuqe mbi kënetë...

S H Q E T E S I M

Ai ishte punimi më i rëndësishëm i atij vendburimi. Për ta projektuar atë, na u desh një punë e përbashkët, që u arrit vetëm pasi i shtrydhëm mirë njohuritë tona. Pastaj shokët ikën. Galeria do të shkonte gjatë, megjithatë vëmendjen më të madhe e kisha përqëndruar te ky punim. Ajo që shfaqej çdo ditë pas plasjes së minave, në të vërtetë ishte e re dhe shpesh e panjohur për mua. Nuk kisha as gjashtë muaj që kurse kisha lënë bankat e fakultetit. Në fillim më kishin caktuar në një zonë ku zhvilloheshin punime zbulimi, së bashku me një koleg më të vjetër në profesion. Po punimet atje ishin në të përfunduar. Ndërkohë ne i kishim shtrirë kërkimet tona në një zonë të afërt. Dhe patëm mjaft sukses. Takuam një pikë të mineralizuar mjaft interesante dhe pas dy muajsh i zhvendosëm punimet në këtë zonë të re. Kolegu im u emërua në një detyrë tjetër dhe gjithë barra e punimeve më ra mua. Nuk më lodhët asnjë punë, aq sa më lodhët mendimi që akoma nuk kisha përfytyrime të sakta për zonën ku punoja, bile, të them të drejtën, as të gjitha llojet e shkëmbinjve nuk i njihja mirë. Lëri pastaj tekat e nëntokës! Por, sido që të ishte puna, nga unë kërkohej që galeritë

dhe punimet e tjera të jepnin mineral. Kjo më entuziazmonte së tepërmë.

Galeria ishte projektuar e drejtë. Shtresat e shkëmbinjve do t'i çante mes për mes dhe, pasi të kallonin dyqind e ca metra, duhej të kapte mineralin. Kjo ishte detyra e saj. Në vështrim të parë, këtu nuk kishte asgjë të vështirë dhe nga harta deri te profili gjeologjik gjithçka zgjidhej fare qartë. Të gjitha këto detyra më dukeshin se mund të zgjidheshin pa shumë komplikime. Minatorët ishin të vjetër në profesion dhe punonin mjart mirë.

Mirëpo tamam në një nga këto ditë pa shumë telashe, siç jemi mësuar t'i quajmë shpeshherë, hyra në galeri aty rrëth orës dhjetë të mëngjesit. Tutje, në thellësi, dallohej flaka e llambës së karbitit dhe që në hyrje vërejta me gëzim se punimi nuk kishte asnjë kthesë. Një tis i hollë tymi e avulli mbushte thuajse gjysmën e thellësisë së punimit. Në front minatorët po mbushnin vagonin, kështu që prita një copë herë të gjatë të kalaja deri në ballë. I shkujdesur, u ula një copë herë mbi shkëmbin e thërrmuar nga plasja e minave dhe i ftova edhe ata të uleshin. Stefani më zgjati kutinë e duhanit. E drodha ngadalë, sepse akoma nuk isha mësuar të pija duhan kutie.

— A u lodhët? — i pyeta tek u pashë ballët të djersitur.

— Nuk bëhet asgjë pa u lodhur, — m'u përgjigj Stefani. — Por sot më duket se do të kemi punë. Fronti ka ndryshuar shumë.

Ktheva kokën nga balli. Një prishje tektonike kishte filluar të shfaqej në faqen e majtë dhe shkëmbinjtë shkrifëroheshin në mënyrë të çuditshme. Shtre-

sëzimet as që dallosheshin më dhe linza të holla balte ndërthureshin midis shkëmbinjve.

— Duhet të zbutet për disa metra, — vazhdoi Stefani. — Mbase na lejon dhe bëjmë dy plasje në turn. I njoh mirë këto zona. Nuk kanë nevojë as për shumë bira. Si thua, inxhinier?

— Mundet, — thashë, pa pasur asgjë të saktë në kokë.

Ishte një linjë tektonike. Kjo dukej qartë. Të tillat mund të mos sillnin asnë komplikim, siç mund të sillnin ndryshime të mëdha. Po të dhënët e sipërfaqes më bënин të isha i sigurt. Kjo tektonikë, po të kishte pasur zhvillim të madh, nuk kishte si të mos pasqyrohej deri në sipërfaqe.

Qëndrova edhe disa minuta akoma dhe ika. Ika pa pasurasnë shqetësim në kokë. Vëmendja ime u shpërnda në merake të tjera dhe ajo ditë e ftohtë janari, me diell, por edhe me ngrica, nuk do të kishte lënë asnë gjurmë në jetën time të punës, sikur të mos ndodhët diçka tjetër...

Të nesërmen më lajmëruan se fronti kishte filuar të pikonte ujë dhe nga tavani ishin shembur nga dy vagona shkëmb. Kjo më detyroi të shkoja përsëri. Kufijtë e tektonikës kishin përfshirë të gjithë ballin dhe zona e shkatërruar tani më ngjalli një shqetësim të befasishëm. Mua, që isha mësuar t'i shikoja shtresat në atë galeri të vendosura kështu në radhë pas njëra-tjetrës, kjo e papritur më zbulonte një situatë krejt të re. Tavani ishte lartësuar së tepërmë dhe për këtë minatorët, para së gjithash, duhej të ruanin veten nga çdo pabesi e nëntokës. I urdhërova të mos bënë asnë hap përpara në ballë, pa e armatosur siç duhej këtë zonë të shembur. U nisa të dilja, po përsëri ktheva mendje. Ishte e para herë që më

takonte rasti të ndodhesha para një gjendjeje të tillë dhe ajo që duhej të bëja, ishte të qëndroja me minatorët, derisa të likudohej e gjithë shembja. Isha vetëm një gjeolog i ri dhe, për të punuar e për të dhënë udhëzime në mbylljen e një zone të tillë të shkriptuar nga tektonika, më shumë duhej të dëgjoja sesa të flitja. Shikoja me vëmendje se si herë pas here shkëputeshin nga tavani copa shkëmbinjsh. Leksionet për artin minerar, ku flitej se si nëntoka, pas shembjes, krijon kubenë e ekuilibrit natyror, kishin tani një vlerë aq të vogël, sa unë nuk dija t'u jepja zgjidhje atyre copave që vazhdonin të binin.

Dolëm përjashta. Dielli ndriçonte fort, dhe sytë e mësuar me dritën e paktë të nëntokës më dhembën. Stefani dhe ndihmësi afroan pranë hyrjes së galerisë nja dhjetë shtylla lisi dhe nisën të preqatit-nin kasat. Pas pak minatori u lodh dhe unë e zëvendësova në sharrë. Ky njeri ishte aq fjalëpak në punë, sa i ashëpër kundrejt atyre që gabonin. Të them të drejtën, s'e kisha pasur gjithmonë këtë mendim të mirë për të. Në fillim, sa e njoha, për mua ishte pakëz i pakuptueshëm. Ndryshonte shumë nga punëtorët e tjerë të ekspeditës. Në zyrë hynte pa teklif, ulej pa i thënë askush të ulej dhe ta thoshte copë atë që kërkonte. Njëherë më kishte rastisur ta dëgjoja kur i kërkonte drejtorit gozhdë shinash, sepse dy ditë në magazinën tonë ato kishin munguar. U habita me taktin e tij, sepse mendoja që, në fund të fundit, nuk kishte pse t'ia kërkonte drejtorit gozh-dët, kur për këtë problem ishte caktuar magazinieri, tekniku, unë dhe kështu me radhë. Kur dola nga shkolla, respektin e punëtorëve ndaj meje e kuptoja pak më ndryshe. Unë isha inxhinier dhe urdhëroja për gjithçka në vendburim. Por me Stefanin nuk

më ndodhte kështu. Më shpesh dukej sikur ai më urdhëronte mua dhe gati më vinte inat. Ai vinte në dhomën time, ulej në fund të krevatit dhe, edhe për gjërat më të vogla, më zgjonte nga gjumi. Ai njeri, sa ishte në ekspeditë, nuk lodhej kurrë. I mobilizonte të gjithë dhe u fliste më të rinjve kur gabonin. Njëherë, pa lejen time, kishte pezulluar punën në të gjitha galeritë dhe kishte mbledhur minatorët të ndihmonin një brigadë shpimi në transportin e sondës. Kur më erdhi të ma njoftonte këtë, më tha shkurt:

— Harxhuam vetëm tri orë punë që do t'i zë vendësojmë. Ata, po të ishin vetëm, do ta bënin transportin në tri ditë, ndërsa kështu, së bashku, e bëmë për tri orë. Kështu e menduam.

Nuk dija se si t'i përgjigjesha.

Atë ditë që punoja më sharrë së bashku me ndihmësin e tij, më tha:

— Djersive, inxhinier? Mirë... mirë. Nuk pëson gjë. Përkundrazi.

Pregatitëm katër kasa dhe çamë disa shtylla të tjera për garnitim. Kur i vendosëm në zonën e shembur, unë shpreha mendimin se hapësirën bosh që mbetej midis kapeleve të kasave dhe tavanit, ta mbushnim me shtylla të plota, të vendosura në formë katriazhi. Kështu e kisha mësuar në artin e minierave.

Stefani më kundërshtoi aty për aty.

— Nuk jemi aq të pasur në lëndë druri, — më tha. — Kjo është galeri kërkimi dhe tavanin mund ta mbushim me gurë e me dhë. Nga këto kemi bollë këtu në ballë.

I thashë se kështu pesha që do të qëndronte mbi

kapecet e armaturave, do të ishte e madhe, por ai më siguroi se kjo peshë nuk sillte asnjë dëm.

Gjithë atë ditë bëmë vetëm atë punë. Kur u ktheva në qendër të ekspeditës, hëngra me aq oreks, sa nuk e kisha pasur prej kohësh. Një ndjenjë kënaqësie shoqëronte lodhjen, dhe isha çuditërisht shumë i qetë shpirtërisht. Cigarja më shijonte më shumë se çdo ditë tjetër. Kisha dëshirë të gjendesha midis njerezve dhe të shkëmbeja me ta ndonjë shaka.

Dy ditë më vonë galeria e kaloi shembjen, por, për habinë time, shtresat kishin ndryshuar drejtim. Tanimë galeria ecte thuajse paralelisht me zgjatjen e tyre dhe nuk i priste më mes për mes si më parë. Kuptohej, se në një rast të tillë nuk i afroheshim aspak mineralit, por mbeteshim në vend. Kjo gjë nuk mbeti pa i rënë në sy as Stefanit, që ma shprehu haptazi mendimin e vet. Nuk iu përgjigja. Ndonjëherë kisha përshtypjen se ai e tepronë, aq më tepër kur ngatërhohej edhe në problemet gjeologjike. U largova nga galeria me një shqetësim të madh. Nuk kisha as me kë të konsultohesha. Tekniku, pikërisht ato ditë, kishte marrë lejen e zakonshme, ndërsa kryegjeologun e kisha larg.

Në dhomën time hapa mbi tavolinë të gjitha materialet grafike. Bënte ftohtë. Dhoma ishte e vogël dhe nuk isha kujdesur të vija as sobë. Megjithatë të ftohtët atë ditë nuk e ndieja fare. Mbi hartën gjeologjike shpalosej gjithë zona, ngarkuar me ngjyra, të cilat më tregonin të gjitha moshat e shkëmbinjve. Vende-vende kishte vija të kuqe tektonikash, por asnjë prej tyre nuk përkonte me atë që ishte shfaqur në galeri. Vrava mendjen disa brë dhe e qetësova veten me mendimin se ajo linjë tektonike mund të sillte ndryshime të parëndësishme. Duhej

avancuar më tej. Shpresoja se shtresat do të kthesin përsëri ashtu siç ishin më parë dhe punimi do të ekte normalisht.

I mbloida materialet dhe vesha peliqen. Të ftohet vetëm tani e ndjeva më shumë. Mbylla dhomën dhe u drejtova për në barrakën ku flinin punëtorët. Sa hyra, ndjeva se ajri ishte shumë i ngrohtë. Soba ishte skuqur nga nxehësia. Stefani diç po shkruante në një fletore, mbështetur pas gjurit. Samiu dhe Namiku po luanin shah. Në njërin nga shtretërit e poshtëm flinte një minator tjeter. Stefani la fletoren mënjanë dhe më buzëqeshi së largu.

— Eja ulu, inxhinier, — tha ai, duke më treguar një karrige.

Të tjerët më përshëndetën dhe vazhduan lojën. Ngrohtësia më vërshoi në trup dhe shpejt e hodha peliqen tej. Disa minuta me radhë nuk shkëmbyem asnjë fjalë. Pastaj dëgjova një «mat!», të qeshurën e Namikut dhe vura re se Samiu e shikonte fushën e shahut me kokën mbështetur në duar.

— Fitova, — tha Namiku. — A bëjmë edhe një lojë tjeter?

— Jo, — u përgjigj Samiu. — U mërzita.

— Epo, besoj se e pranon veten se je nxënësi im, apo jo? — vazhdoi ta ngacmonte më tej Namiku.

— Nuk e kuptoj fare këtë lojë, inxhinier, — tha Stefani. — Duhet të jetë e bukur, përderisa i shoh këta djem të bien përbys mbi të sa vijnë nga puna. Beson, nuk çlodhen fare!

— Të çlodh trurin, — i thashë.

— Nuk të lodh?

— Edhe të lodh. Po a e di se pse erdha? A mund ta bëjmë galerinë tuaj me tre turne?

— Pse?

— Sepse duhet të avancojmë më shpejt, Stefan. Ajo që na doli tani përpara, duhet të sqarohet sa më parë. Si mendon ti?

— E bëjmë, — tha ai, duke rrudhur ballin. Flökët e tij të zinj kishin nisur të zbardheshin mbi tëmtha. I nguli sytë sobës dhe heshti një çast. — E bëjmë! — përsëriti. — Nuk humbasim asgjë. Si thoni ju, djema?

— Po u desh, — tha Namiku, — do ta bëjmë. Na mbajti ca kohë në vend ajo djall shembje, po do t'i arrijmë metrat që humbëm.

Avancimi i shpejtë sqaronte komplikimin që kishte lindur. Isha si ndër ethe. Galeria po i afronte dyqind metrat dhe, të mos merrje asnje rezultat, ishte një humbje e madhe. Nuk shfaqa ndonjë mendim tjetër. Caktova turnin e tretë që do të fillonte punën të nesërmen në atë galeri dhe, pasi u urova shokëve natën e mirë, shkova në dhomën time.

Para se të flija u hodha edhe një sy materialeve grafike. E lodha trurin për afër një orë dhe u binda përsëri se atje nuk po gjeja asnje përgjigje tjetër. Për herë të parë u binda se kisha shumë e shumë nevojë të dija më tepër, të mësoja më shumë. Lekcionet e fakultetit i mbaja gjithmonë me vete. Shfletovat shumë prej tyre, por asgjékund nuk gjeja ndonjë mendim të saktë për të dalë nga kjo situatë. Kuptoja gjithashtu se, për të tilla raste, nuk ka receta. Gjithkund flitej për lloje të ndryshme tektonikash dhe rrudhosjesh, për lëvizje të fundit të basineve detare në mosha dhe zona të ndryshme gjeologjike, për rryma të trubullta e të mbingopura me materialin e imtë të lumenjve kontinentalë që do të formonin shtresat e ardhshme shkëmbore, po për këtë prin-

shje që më kishte përbysur situatën në këtë galeri të vendburimit, nuk flitej gjökund.

Ato ditë kaluan të gjitha të mbushura me këtë shqetësim. Shtresat vazhdonin të ecnin paralelisht me galerinë dhe i gjithë avancimi nuk e afronte mineralin as edhe një metër. E keqja më e madhe ishte se këto shtresa ndryshonin shumë nga shtresat para tektonikës. Të jepnin përshtypjen se ato i përkitnin një moshe më të vjetër gjeologjike, e cila nuk kishte asgjë të përbashkët me mineralin. Në ballë, thuajse vertikalish, qëndronin po ato shtresa strallesh të forta, që vështirësonin shumë avancimin. Stefani shpesh ankohej se barominat konsumoheshin si të ishin prej alumini dhe as dhjetë copë prej tyre nuk i mjaftonin një turni. Tri ditë me radhë shkova në galeri pas çdo plasjeje. M'u desh t'i bëja punimit një planimetri me busull dhe metër e ta hidhja në hartën e madhe. Vura re se zgjatimi i tij po i afrohei trupit të mineralit, ashtu siç e kishim përfytyruar zhytjen e tij në thellësi. Megjithatë shtresat në ballë vazhdonin të qëndronin në këmbë.

Në galerinë fqinjë çdo gjë vazhdonte normalisht. Midis tyre nuk kishte ndonjë distancë kushedi se çfarë dhe ky fakt më mbante të gjallë optimizmin. Mund ta devijoja galerinë dhe të ecja kryq me shtresat, po ky ndryshim nuk më sillte asnjë dobi. Në galeri ndodhesha para një errësire të heshtur, dikur llum e baltë dhe tani shkëmb. Dikur oqean e tani thellësi mali me të papritura të mëdha. Dikur këtu lëvrintejeta e gjallë e mikroorganizmave, kurse tani lëvrinte mendimi njerëzor për të përcaktuar moshat e shtresave, nëpërmjet kufomave të fosilizuara të atyre mikroorganizmave. Bëra disa matje me busull, skicova ballin e punimit dhe u ktheva në dhomë.

Arrita në përfundimin se, për ta sqaruar përfundimisht këtë situatë, duhej një punë e madhe. Ndërkojë galeria duhej të avanconte. Telashet e një pune të tillë nuk më trembnin. Kryesorja ishte që ato dyqind e ca metra galeri të justifikonin djersën e derdhur dhe shpenzimet.

Të gjitha ditët dhe netët e asaj periudhe ishin mbushur me shqetësime të tilla. Stefani, siç dukej, e kishte vënë re këtë, po ngaqë nuk dinte si të më ndihmonte, e shprehte përkrahjen e tij duke punuar më shumë. Galeria avanconte si kurrë ndonjëherë. Të gjitha përfundimet e njohurive të mia të çonin në një pikë. Galeria duhej të ekte vetëm përpara. Çdo devijim ishte fare i kotë. Mbyllja, e papranueshme. Ai punim i shtonte vendburimit rezerva të konsiderueshme. Të gjitha këto i kuptoja fare mirë. Mbi shpatullat tona qëndronte një detyrë e vështirë.

Atë mbrëmje binte shi dhe frynte erë. Kjo kohë kishte dy ditë që vazhdonte kështu. Kush është gjeolog, e di mirë se në një kohë të tillë as që mund të bësh punë në terren. Megjithatë unë punoja. Se sa lodhesha dhe lagesha, kjo as që tregohet. Si çdo natë, qëndrova deri vonë. Mbi tavolinë kisha një sërë rrelacionesh dhe raportesh të kolegëve të mi më të vjetër. Edhe kur shtrihesha në krevat, para se të më zinte gjumi, lexoja disa faqe prej tyre. Nuk kisha as ndonjë orë që më kishte zënë gjumi, kur ndjeva t'i binin derës së dhomës simë. U ngrita shpejt. Para meje qëndronte Stefani. Megjithëse përgjumësh, e vura re menjëherë që ai ishte i lagur, sado që mbante në trup mushama të shkurtër dhe kapuç të gomuar.

— C'ndodhi? — e pyeta i shqetësuar.

— Nuk e di, — tha ai si me mospërfillje, — por erdha të bisedojmë.

— Për se është fjala?! — i thashë gati i zemëruar.

— Për galerinë, — m'u përgjigj. — Tani vij nga turni dhe më duket se diçka ka ndryshuar.

Më iku gjumi fare dhe vajta të vishesha. Këto pak fjalë i kishim shkëmbyer në prag të derës së dhomës.

U ulëm pranë e pranë mbi krevatin tim të prishur dhe me çarçafë akoma të ngrohtë. Ai më tregoi se, kur kishte filluar të bënte birat, në fillim baromina kishte hasur një zonë të butë dhe pastaj përsëri në shkëmb të fortë. Birat, deri në gjysmë metër, bë-heshin aq lirisht, si të shpoje në gjalpë. Më pas çdo gjë ndryshonte. Kjo gjë i kishte bërë përshtypje dhe, pas plasjes së minave, ashtu nëpër galerinë e mbushur me tym, ishte futur të vështronë ballin.

— Nuk mundesha të qëndroja as pesë minuta, — vazhdoi ai, — sepse tymi t'i sillte zorrët në grykë. Po m'u desh të rezistoja. M'u duk sikur shtresat fillojnë të kthehen përsëri ashtu si para se të fillonte shembja. Ndaj erdha të të zgjoja. Nuk e di, kështu m'u duk!

Zëri i tij dukej sikur nuk shfaqte asnjë emocion, por, në të vërtetë, ndodhë krejt e kundërta. Ky njeri, vigan nga trupi, me fytyrë të gjatë enofulla të fuqishme, kishte sy të kaltër, çuditërisht shprehës. Ai më vështronë me dhemshurinë e babait. Balli i ishte valëzuar nga rrudhat. Duart e mëdha, të lidhura në-përmjet gishtave që i lëvizte midis gjunjëve, i ngjanin një vareje të rëndë që shkatërronte gjithë shqetësimin tim. Në këtë dhemshuri dalloja një ironi të lehtë, gati gazmore, siç duket ngaqë më shikonte kështu, akoma të hutuar e të përgjumur. Një lajm si ai që po më sillnin, për një punim tjetër, nuk do të

më ngjallte asnjë interes. E dija se nëntoka ka teka të mëdha. Po ky lajm kishte për mua një rëndësi të jashtëzakonshme.

Pa e bërë të gjatë, vesha peliqen, çizmet dhe u bëra gati të nisesha. Ai u ngrit dhe më preku lehtë në sup.

— Bie shi, — tha dhe më buzëqeshi, sikur shiu të ishte një lodër fëmijësh që më priste përjashta.

Strehët prej llamarine të barrakave zbraznin në tokë rrëke të vërteta. U futa midis rrebeshit me mendjen tek ajo pamje e re që ishte shfaqur në ballin e galerisë, mjegulluar nga tymi i eksplozivit. Ai më ndoqi pas. Ishte e kotë ta lutja të kthehej. Sapo kishte mbaruar turnin e dytë dhe e dija se duhej të flinte. Megjithatë, ashtu siç zgjonte të tjerët në mes të natës, ky njeri besoja se nuk dinte as të flinte. Ecnim të dy pas njëri-tjetrit përmes shiut. Rruga as që do të dukej pa dritën e zbetë të projektorit të tij që njollose errësirën e lagët. Shpejt e ndjeva lagësh-tirën të më qullte pantallonat nga gjunjët e poshtë, pastaj mëngët dhe të më depërtonte në gjithë trupin. Ai ecte përpara, ashtu trupmadh siç ishte, me kokën pakëz të ulur, kurse unë e ndiqja hap pas hapi.

Në galeri turni i tretë apo zbrazi vagonin e parë. U habitën kur na panë të mbërrinim aty aq befasisht, në mes të natës. Samiu e pa minatorin e vjetër me admirim. Ai i dha ujë llambës dhe nisi të mblidhët ca ashkla për të ndezur zjarr.

— Nuk është nevoja, — tha Stefani. — Si thua ti, inxhinier?

— Po, — iu përgjigja. — Sa të shohim frontin.

Në ballë sterili kishte zënë pothuajse gjysmën e lartësisë dhe ishte e vështirë t'i dalloje të gjitha shtre-

sat. Megjithatë gërmova me çekiç në faqe dhe dallova një tektonikë që sapo kishte braktisur rrugën që çante galeria. Shkëmbinjtë ishin akoma të shkrifët e të copëtar nga plasja e minave dhe nga ndikimi i tektonikës. Stefani qëndronte pas meje. Edhe ata të turnit të tretë më vështronin dhe heshtnin. Aty për aty më lindi një mendim tjetër. Sikur të ishte e mundur të avancohej akoma edhe ndonjë gjysmë metër, gjithçka duhej të sqarohej mirë. E pleqërova këtë mendim me minatorët. Stefani tha se kjo mund të bëhej që atë kohë, pa qenë nevoja të pritnim mëngjesin. Ata të turnit të tretë vështruan njëri-tjetrin.

— E thjeshtë, — tha Stefani. — Lëvizim sterilin nga vendi dhe e hedhim me lopatë disa metra më tej. Pastrojmë frontin dhe bëjmë birat. Pas dy orësh gjithçka përfundon.

Ai hoqi xhaketën dhe iu përvesh punës i pari. Unë shfaqa edhe një mendim tjetër. Meqë ishim kater vetë, dy të lëviznin sterilin dhe dy të tjerët të mbushnin vagonin. Le të nxirrnim jashtë sa të mund-nim.

Në më pak se një orë e gjysmë fronti ishte gati. Rrëketë e shiut që më kishin fshikulluar fytyrën, tani ishin tharë dhe vendin e tyre e kishin zënë rrëketë e djersës. Asnjë zjarr nuk do të na ngrohte më shumë sesa ajo lopatë e thjeshtë dhe dëshira për ta zbuluar të panjohurën sa më parë. Ky mur shkëmbor fshihte pas vetes gjithë ankthin tonë. Megjithatë, ai as që ishte më në gjendje të na rezistonte.

Ndihmësi i Samiut shkoi të lajmëronte motoris-tin të lëshonte ajër. Vetëm aq kohë gjetëm, sa të pinim një cigare. Befas u drodh pistoleta, dhe ne filloam birat. As që kisha punuar ndonjëherë me pistoletë. Pluhuri vërshonte nga të gjitha anët dhe zbehte

dritën e llambës. Gati-gati më dhimbte barku kur mbështetesha fort mbi dorezën e pistoletës. Veshët më buçitnin. E ndieja se baromina herë avanconte lehtë e herë e shtynte pistoletën prapa, e pabindur të ecëtë më tej. Ne u ndërruam të katër me radhë, kështu që nuk na takoi të bënim veçse nga tri bira secili. Samiu donte ta bënte vetë edhe birën time të tretë, po Stefani nuk e la.

Samiu filloi t'i mbushte birat me eksploziv dhe ne, ndërkohë, u larguam nga fronti. U futëm në një traversë të bërë apostafat për të tilla raste. Aty pritëm. Pas pak u ndie era e barutit të ndezur dhe hapat e Samiut që shpejtonte përgjatë galerisë për të ardhur te ne. Disa sekonda më vonë filluan shpërthimet. Në traversën e armatosur mirë ato ndiheshin të largëta e megjithatë pluhuri i tavanit depërtonte përmes shtyllave dhe na binte në kokë. Sa kohë zgjatën shpërthimet, ne nuk këmbyem asnjë fjalë. Vetëm numëronim plasjet secili për vete. Dy të fundit u ndien dobët. Stefani tha se ato ishin birat e dyshemesë.

Fill pas plasjeve u ngrita të shkoja në ballë, po një dorë e fuqishme më mbërtheu në vend.

— Duhet pritur, — tha Stefani. — Sipas rregullit, të paktën njëzet minuta. Pastaj aty ka aq tym, sa mund të mbytesh. Durim!

Ato minuta m'u dukën orë të tëra. Padurimi im sa vinte dhe shtohej. Ajo që sapo ishte shkatërruar, hapte dyert e suksesit ose të mossuksesit. Ditë të tëra e kisha ndier shqetësimin që sillnin këto dy kulme në jetën e punës sime. Megjithatë ky shqetësim, të cilin unë isha munduar ta mbaja për vete, tani ishte shpërndarë edhe tek ata që më rrinin pranë. Kjo ishte njëlloj sikur të të hiqnin një pjesë të barrës. Kështu

shqetësimi vërtet bëhej më i lehtë, por të mobilizonte më shumë.

Gjysmë orë në vonë ne i preknim shtresat e reja me aq gëzim, thuajse ato të ishin vetë minerali. Ca stralle të bardha, të dobëta dhe të shkrifëta na flitnin qartë se pas tyre shtresa gjendej jo shumë larg së andejmi. Ne duhej të vraponim mes disa qindra mijëra vjetësh, për vetëm disa ditë dhe të gëzonim frutet e djersës që derdhëm së bashku.

JETA MBI SHKËMBINJ

Unë dhe Jani, kështu e quanⁿ djalin që punonte te ne si shoqërues, ishim ulur në një qafë të vogel mali. Para nesh shtrihej një humnerë e zezë që sa vinte nxihej më tepër nga muzgu i mbrëmjes. Kishte ardhur maji. Ne që e kishim kaluar dimrin në mes të këtyre maleve, e pritnim pranverën e parë me padurim. Malet heshtnin. Mbiu i pari yll. Qielli ishte i pastër. Përroi zhurmonte mes errësirës së humnerës. Nën ne toka gërryhej e copëtohej nën goditjet e pistoletave të minatorëve. Ai pinte cigare. Të dy vështronim mes kësaj errësire, që sa vinte e shtohej, një dritë të vetmuar që mezi shquhej së andejmi. Dukej si ndonjë yll që ishte shkëputur nga qielli, nuk ishte shuar ende dhe tani kishte mbetur pezull për një çast në hapësirën e errët.

— Është ai... po, ai! — tha atë çast Jani, duke zgjatur dorën drejt dritës.

Ky zë m'u duk i largët, sado që e ndieja aq pranë këtë djalosh. U rrëqetha. E dija ç'më tregonte. Para ca ditësh kishte ardhur në minierën tonë një gjeolog i ri me të cilin ende nuk njiheshim mirë. Ai që ditën e parë, pasi zuri vend në barrakën e kryeinxhierit, doli luginës. Askush nuk e kishte parë akoma të futej galerive. Ne zakonisht tregohemi kureshtarë

për njerëzit e rindjeve. Po gjeologu nuk na ishte afruar fare. Nga ftyra mund ta merrje edhe për njëzet e shtatë vjeç por edhe për tridhjetë e pesë. Një shenjë plage i zbriste nga balli deri afër veshit. Trupin e kishte të dobët, të gjatë dhe në sy i pasqyrohej një shqetësim i vazhdueshëm. Me pak fjalë, ishte pak i kuptueshëm. Rrugës ai i përvihendoste të gjithë sikur t'i njihte prej kohësh. Edhe mua më kishte përvihendetur diku, megjithëse atë ftyrë nuk e kisha parë kurrë në jetë.

Disa ditë me rradhë, çdo mbrëmje, unë dhe Jani rrinim pas punës në atë qafë të vogël mbi galerinë numër 10 dhe pothuajse çdo mbasdite na kishte rastisur ta shikonim gjeologun atje tej, në faqen më të pjerrët të Skotinisë. Atë mbrëmje ai, siç duket, ishte vonuar më shumë se zakonisht dhe Jani, pikërisht atë ditë, fliste me një farë ankthi që mund ta vije re mirë. Atë çast ai ngriti supet dhe shoqëroi me sy atë dritë, që për një sekondë na u zhduk nga sytë.

— I çuditshëm! — murmurita. — Ti e njeh mirë, Jani?

— Si asnjë tjetër, — u përgjigj. — Jeta ime po lidhet pas këtij njeriu aq ngushtë, sa me asnjë tjetër.

— Nuk e kuptoj fare, — këmbéngula unë.

— Duhet ta kuptosh, — tha djali, duke ulur kokën. — Njeriu nuk duhet të jetojë kurrë përvete. Këtë ma mësoi së pari ai, Fredi, — dhe drejtoi dorën andej, nga mezi dallohej drita.

Drita ecte përmes muzgut të mbrëmjes. Hapa nuk dëgjoheshin. Ajo jetë që e kishte bërë aq shumë përvete shokun tim të ri, ushtonte tanë larg nesh.

Unë dhe Fredi erdhëm për herë të parë në këtë vend aty nga fundi i korrikut të shkuar. Punonim diku njëzet a tridhjetë kilometra larg së këndejmi në një ekip kërkimesh. Atëherë nuk kisha veçse disa muaj që kisha lënë bujqësinë dhe kooperativa më kishte caktuar të punoja si punëtor në gjeologji. Pritja të futesha në galeri, por, për çudinë time, inxhinieri më tha se do të punoja si punëtor marshrutash. Atëherë nuk e kuptoja se ç'donte të thoshte marshrutë dhe kundërshtova. I thashë se nuk kisha punuar kurrë me marshrutat dhe, sa të turpërohesha, më mirë le të punoja së bashku me shokët e tjerë. Ai qeshi dhe ma shpjegoi punën time me pak fjalë. Nuk kerkoi gjë tjetër prej mëje, veçse ta shqëroja inxhinierin gjatë kërkimeve të tij. Unë natyrisht i njihja mirë të gjitha këto anë, sepse qysh fëmijë babai më kishte mbajtur në stane bashkë me kopenë. Shpejt u mësova me punën e re. Ai më nxiste çuditërisht fuqishëm të mësoja shumë nga ato fjalë që shkruante nëpër blloqet e tij. Dhe mësimi i parë prej atij njeriu ishte faji që duhej të ndieja, që kisha lënë shkollën. Nejse, kjo është tjetër mesele. Me sa mësova, shumë vjet përpara në fshatin tonë kishte ardhur një gjeolog i huaj dhe tanë inxhinieri im pyeste fshatarët që mbanin mend, se ku kishte hapur ndonjë punim ky i huaj. Një plak diç i kishte treguar. Që atë ditë për ne filluan rrugë aq të gjata, sa nuk kishim mundësi të kthehem në darkë në fshat.

Një mbrëmje nga këto e pashë shumë të mërzitur. Ishte përkulur mbi hartën e tij të vogël, që nuk ngjante fare me ato hartat që kisha parë unë

në shkollë, dhe mendohej e mendohej. Pastaj ngrinte kokën së andejmi dhe fillonte të më pyeste mua. Herë interesohej për Shtegun e Kulprit, herë për Stanin e Maret, për Hijen e Brinjës, për Kreksin e ku tadi unë. Një mbrëmje më kërkoi hollësira për Përrallin e Derrave. I thashë se nuk kisha qenë kurrë atje, por e dija se binte matanë malit.

Ky muhabet bëhej çdo mbrëmje. Më së fundi një ditë u kthyem nga puna më herët se zakonisht. Ishte i menduar. Nuk kërkoi as të hante. I hodhi me të shpejtë edhe një sy hartës, shënoi diçka me laps, pastaj më thirri pranë.

— Jani, a e di, nesër mendoj të nisemi. Punëtorëve do t'u jap pushimet e muajit. Kështu që, he-përë këtu nuk kemi asnë punë. Ti preqatitë mirë. Na gjej dhe një kafshë këtu në fshat. Do të na duhet të marrim me vete çadrën e vogël fushore dhe disa gjëra të tjera.

— Po ti, nuk do të shkosh në shtëpi për pushime? — e pyeta i habitur.

— Jo! — tha me vendosmëri. — Nuk do të shkoj. Ndoshta pas një muaji, po kjo nuk ka aspak rëndësi. Ti e kuption, duhet parë ky vend, — dhe goditi hartën me gishta.

Ngrita supet. As që i kuptoja ato gjëra për të cilat më fliste. Megjithatë bëra siç më porositi. Gjeta një kafshë, ngarkova në të çadrën, disa batanije, ca ushqime të thata për katër ditë. Të nesërmen u nisëm që pa gdhirë. Rruga ishte e vështirë, po koha e bukur. Unë ecja më shumë pas mushkës. Ai herë pas here largohej aq tepër nga unë, sa shpesh trembesha se mos humbiste rrugën dhe nuk do të takoheshim më. Kështu që detyrohesha të pritja. Ai kthehej gjithmonë me ca copa gurësh nëpër duar.

Rastiste që mbushte edhe xhepat. Në fillim men-doja se mos kishte gjetur ndonjë gjë interesante, ndonjë mineral, për shembull. Por ai më përgjigjej:

— Jo, Jani, këto janë ca kampione të bukura.

Çanta mbi mushkë mbushej ngadalë. Aty mund të shikoja dhjetëra copa stërralli me ngjyra të ndryshme (këto më bënин një farë përshtypjeje), gëlqerorë pa asnje bukuri të veçantë, shiste, siç i quante ai, dhe në raste të rralla ndonjë copë kristal me ngjyrë të përzishme.

Nata e parë na zuri afër vendit, për të cilin ai interesohej. Jo shumë larg së këndejmi. Ja, e shikon, paksa në atë majën atje. Gjetëm vend për çadrën, e ngritëm, ndezëm zjarr përjashta dhe i treguam njëri-tjetrit ngjarje nga më të ndryshmet. Natën bënte ftohtë. Mbi çadër fëshférinin fletët e lisave shekullorë. Vendi, siç e shikon edhe vetë, është shumë i pyllëzuar.

Kur unë fillova të pregetitja darkën për të dy, ai u shtri mbi bar. Yjet dukeshin të qeshura. Zjarri përhapte përreth një dritë të verdhë që shtrinte përtokë me qindra hije trungjesh të shtrembra pylli. Më kujtohet se si atë natë ai ia mori këngës. Kishte një zë të bukur, të ëmbël, të ngrohtë. Mushka kulloste e lidhur disa hapë larg nesh.

Ramë të flinim, por atë nuk e zuri gjumi shpejt. Mua më mbylleshin sytë nga lodhja. U kthyesh brinjas nga unë dhe tha:

— Jani, nesër duhet të ngrihem përsëri herët. Mendoj se jemi atje ku na intereson. Ai (siç duket e kishte fjalën për gjeologun e huaj) as që mund ta ketë sqaruar deri në fund këtë shtresë. Sepse e kam një parandjenjë të tillë....

Pastaj, kur e pa se nuk iu përgjigja — se nuk

dija ç't'i thosha — ai më uroi natën e mirë. Po përvete nuk fjeti shpejt. Derisa më zuri gjumi, e pashë të mendohej me duar të kryqëzuara nën kokë, duke vështruar kulmin e shtrembër të çadrës.

Të nesërmen punuam deri në drekë. Pastaj ai më urdhëroi të prishja çadrën dhe ta vendosja në faqen tjetër të luginës. Për vete vazhdoi punën. Bile mbajti edhe çantën e kampioneve. Tek ngarkoja mushkën, e pashë që u zhduk në mes të pyllit. Pylli e kishte fajin. Ndryshe ai do ta gjente menjëherë atë që kërkonte.

Po ngrysej. Ai nuk po kthehej ende. Kjo më bëri shumë merak. Më tepër sepse mbante dhe çantën e kampioneve. Lidha mushkën, shojta zjarrin dhe u nisa ta kërkoja. Pylli ishte i dendur. Një pyll në shpat të malit. Ngjitja më bëhej çdo hap më e vështirë. Djersët më mbuluan ballin, fytyrën, gjithë trupin. Ai nuk dukej gjékundi. Më vinte habi se si mund ta tërhiqte pas vetes gjithë atë çantë me kampione. Pas pak pylli filloj të rrallohej. Në vend të tij më dolën para sysh ca shkëmbinj të murmë shumë të shtresëzuar që ngriheshin si greminë. Aty nuk dija nga t'ia mbaja më. Thirra:

— Fredi... O Fredi! Inxhinier!

Asnjë përgjigje. Ecja në fund të greminës. Vendin filloj ta rrihte era. Ecja dhe mendoja për këto vise kaq të ashpra. Mendoja për shokun tim të shtigjeve të panjohura, për jetën e tij në mes të këtyre viseve. Unë atëherë as që e kuptoja emocionin e tij.

E gjeta vetëm kur ishte errësuar fare. Mbi shkëmbinjtë ndriçonin yjet. Ai ishte ulur shtruar në tokë dhe gërmonte me çekiç. Çantën me kampione e kishte lënë aty mënjanë. Në buzë i dridhej cigarja. As që e ndjeu se si iu afrova. Shkruante në gjysmerrësirë.

Kushedi sa do tē rrinte aty, sikur tē mos e përmendja.

— Mirëmbërëma, inxhinier! — e përshëndeta.

— O, Jani! Mirëmbërëma! — ma ktheu me zë tē butë. — Sot vërtetova atë që më shqetësonte. Dëgjo, Jani. Nesër duhet tē kontrollojmë luginën. Pasnesër shpatin tjetër tē malit. Edhe dy ditë na mbetën, — përfundoi me dëshpërim.

— E kuptoj, inxhinier.

U ngritëm tē iknim. Kur hodha çantën mbi supë, u habita se si ai kishte mundur ta zvariste këtyre shkëmbinjve gjithë ditën.

2.

Litarin e lidha fort pas shkëmbit. Ndërkohë ai kishte hequr xhaketën, mbështolli pas vetes anën tjetër tē litarit dhe, duke futur në xhepat e pantallonave busullën, bllokun dhe një shirit-metër tē vogël, më tha:

— Nuk do tē kesh shumë punë. Unë jam i lehtë nga pesha dhe shkëmbi më mban mirë. Vetëm kujdes, ta lëshosh litarin metër pas metri. Kjo ka shumë rëndësi. Vetëm kështu mund t'i shikoj tē gjitha shtresat.

Heshti, pastaj vështroi poshtë. Para syve tanë shtrihej një greminë e thellë. Përroi mezi shquhej së andejmi, si një fiongo e kaltër përmes një brezi tē hollë zallishtesh tē bardha.

Unë kafshova buzët, kur ai u kap fort pas litarit dhe u hodh në greminë. Litari u tendos aq shumë, sa mua m'u duk atë çast se do tē këpuntej. U hodha menjëherë ta shtërgoja. Dy-tre metra poshtë ai ndenji

pezull në ajër. Pastaj u rrotulla së bashku me litarin, vetëm në një çast mbështeti këmbët mbas shkëmbinje dhe qëndroi.

Unë e lëshova litarin një pash. Ai më thirri tanë sipër. Nga kjo u gëzova. «Ndoshta e kuptoi që këtu nuk zurret asnjë njeri me mend në kokë», mendova. Mirëpo, pa u ngjitur akoma në buzë të greminës, ai më tha t'i lidhja në mes një çantë të vogël të pre-gatitur posaçërisht që më parë për atë punë e që do t'i nevojitej të fuste kampione. Kjo më trubullloji shumë. Por ai nuk më dha shkas të mendoja. Hodhi rripin e çantës pas mesi dhe më urdhëroi të lëshoja litarin.

Ai zbriste metër pas metri. Gremina dukej e pa-fund. Zemrën ma kishte mbërthyer një ankth që nuk tregohej. Po sikur të këpütej litari? Po sikur të goditej diku pas shkëmbinje?

Përballë malet ishin të ashpra. Dy shpate të egra takoheshin me njëri-tjetrin e krijonin midis tyre një guvë të gjatë, nga buronte, siç dukej, përrroi. Një natë më parë ai e kishte quajtur «të tmerrshme» gjithë këtë grykë. Dielli shkëlqente i nxeh të. Në atë qetësi të thellë dëgjohej vetëm krisma monotone e çekiçit të atij që godiste shkëmbinjtë. Isha mybutur në djersë. Rastiste që shkëpütej ndonjë copë gur nga gremina dhe të përfundonte fluturimthi në përrua. Atëherë e humbisja fare. Mallëkoja veten që e lashë të ndërmerrte një punë të tillë. Pastaj më ngushëllonte pafajësia. Një mibrëmje më parë ne ishim grindur gjithë natën. Unë e kisha parë atë greminë dhe nuk doja që ai të zbriste andej. Mirëpo... hajde mbushi mendjen! Mbaj mend që më vështronë me ata sy aq ëndërrimtarë kur i flitja dhe zinte e më thoshte:

— Jani, ti duhet ta kuptosh. Unë mendoj se shtresa duhet të dalë vetëm në këtë greminë. E di, këtu kemi të bëjmë me një sinklinal. E di q'do të thotë sinklinal? — dhe fillonte të më shpjegonte me durim. Pastaj vizatonte para meje dhjetëra skica, i prishte përsëri, grindej me to. Unë e vështroja i habitur. Nuk e kuptoja se si njerëzit mund të mallën-gjehen kaq shumë pas shkëmbinjve...

Ai vazhdonte të zbriste metër pas metri. Tani sikur u mësova me ankthin. Mbi greminë ra hija. Shquante qartë këmisha e tij e bardhë, mes shkëmbinjve të murmë. Kur qëndronte, mbështeste këmbët fort pas murit të shkëmbinjve. Me njëren dorë mbante litarin, kurse me tjetrën shkëpuste copa shkëmbinjsh. Mendo sa e vështirë duhet të ishte ajo punë. Të shkulësh shkëmbinj me thonj! Çanta e vogël në mesin e tij mbushej e mbushej. Me siguri duhej të rëndonte shumë.

Ai rrëshqiste mes shkëmbinjve. Më mundonte dicëa tjetër: Po sikur të mos na arrinte litari? Po sikur të mos gjente asnë shtresë? Atëherë gjithë mundi i tij do të shkonte kot. Atëherë do ta shikoja të lodhur e të mërzitur si asnijëherë tjetër.

Lëshova edhe një metër. Atë çast ndjeva se si u tund litari dy herë. Kjo donte të thoshte se duhej të lëshoja akoma. Tani nuk e shikoja më. Gremina, siç dukej, përkulej nga brenda. Ato minuta m'u dukën orë të tëra. Ai e tundi përsëri dy herë litarin dhe unë lëshova akoma. Kur, befas, një thirrje që mezi ngjitej nga honi i thellë:

— E gjetaaaa!

U rrëqetha. Më pushtoi një tjetër frikë. «E gjeti?!» — thashë. Shtresën, me siguri. Nga gjëzimi ai mund të bënte ndonjë marrëzi ato çaste. Unë rrija

i përkultur sipër greminës. Flladi më shpupuriste flokët. Unë as që e ndjeva veten në atë qafë të shkretë. Shpirtërisht isha edhe unë atje, në mes të greminës, me inxhinierin tim.

Dëgjo, vëlla. Ka njerëz dhe njerëz në këtë botë.

U ngjit deri tek unë me një gëzim të tillë në fytyrë që nuk ta rrëfej dot. Më përqafoi, më puthi, sikur të isha vetë unë ajo pér të cilën ai përpinqej. M'u duk shumë i pashëm në ato çaste. Sytë i qeshnin. Fytyrën e mprehtë ia kishin mbuluar djersët. Një tufë flokësh i ishte ngjitur mbi ballë. Duart i kishte të gërvishura, aty-këtu të gjakosura.

— Duhet të zgres edhe një herë më tej, — më tha, duke qeshur. — Shtresa duhet të sqarohet e tëra. Merre litarin dhe shkojmë.

Mbi greminë kishte një rrugë kafshësh. Unë e ndoqa pas. Nuk më bënte zemra më t'i kundërshtoja. Do të kërkoja të zbritja vetë në ato çaste, sikur ta dija se do ta kryeja punën. Eh, po unë nuk merrja vesh fare nga gjeologjia.

Mirëpo kësaj radhe ndodhi diçka tjetër. Litari mbaroi para se ai të gjente shtresën. Vendi ishte shumë i pjerrët, po jo më greminë. E pashë nga lart se si rrinte pa lëvizur, me litarin pér mesi, duke vështruar andej nga zbriti herën e parë.

Pas pak nisi të lëvizte lirisht mbi shkëmb. Kjo më habiti në fillim. Pastaj kuptova gjithçka. Ai e kishte zgjidhur litarin nga mesi dhe mundohej të zbriste i pasiguruar. Kjo gjë më ngriu gjakun.

— I qmendur! — e shava që lart. Por ai nuk e ngrinte kryet.

Ndiqja me vërejtje gjithë lëvizjet e tij. Litarin e lirë e mbajta i pafuqishëm në duar. Vura re që u mbështet lirisht mbi ca shkurre të vogla, pa diçka

me interesim dhe përsëri desh të bërtiste, si dukej. Mirëpo ndërroi mendje. U ngjit edhe ca më lart. Aty qëndroi gjatë. Ishte shtrirë barkas mbi shkëmbinj. Gjithë vëmendja ime ishte përpirë në ato çaste mbi këtë njeri, që kërkonte të bënte të pamundurën. Për herë të parë e ndjeva veten një cikërrimë para tij. C'po bëja unë për të? Litari i lidhur pas shkëmbit lëkundej lirë sa nga njëri krah në tjetrin. A mund ta shpëtoja atë njeri vetëm me shqetësimet që ndieja. Kurrsesi. E pashë që ngriti kokën drejt meje. U ngjit edhe pak metra më lart. E kuptova që donte të arrinte litarin. U kap pas një shkurreje të vogël, shtriu këmbën anash dhe u mbërthye përsëri pas shkëmbinjve.

— Jani! — thirri atë çast me sa kishte në kokë. Dielli i binte në sy.

— Eeeeej..., — iu përgjigja.

— A mundesh, — tha papritmas dhe buzëqeshi. Mezi ia dallova atë buzëqeshje. Ishte aq e largët, sa edhe fundi i hummerës.

E kuptova. Kisha kohë që isha shpirtërisht aty, në shpatull të greminës, pranë shokut tim...

Çasti i parë m'u duk shumë i vështirë. Litari u rrotullua së bashku me mua dhe u lirua ca. Po kjo ishte e gjitha. Pëllëmbët e duarve më përvëlonin tek rrëshqitnin mbi litarin e trashë. Diku qëndrova. Vështrova poshtë. Ndjeva vështrimin e shokut që ndiqte me shqetësim zbritjen time. Kjo ma ngrohu zemrën. Një lehtësim i çuditshëm më mbushi shpirtin...

Unë dhe ai zbritëm më pas hone dhe greminë të tjera. Megjithatë nuk mund ta harroja kurë zbritjen e parë, guximin që më fali inxhinieri im...

Jani heshti. Drita mes errësirës nuk dukej më.

Inxhinieri, siç dukej, po ngjiste tani shpatin e qafës ku ishim ulur në.

Atë çast u ndie një shpërthim i fortë. Ishin minat e galerisë numër 10. Malet shkundën qetësinë. Cshëtima e minave, kur u përplas pas grykës së Skotinisë, erdh e u kthye në një zhurmë orteku.

Gryka e llahtarshme ishte mposhtur.

Mbi shpatin e malit u duk një dritë. Tani ne e dallonim që afrohej me shpejtësi drejt nesh. Jani ndezi një cigare tjetër.

MYSAFIRI I NATEŚ

Duhej të kishte kaluar mesnata. U zgjuam pa-pritmas nga një e trokitur e lehtë në derën e poshtme të shtëpisë. Mamaja thoshte më pas, se ishte akoma zgjuar dhe të trokiturat i kishte dëgjuar mirë. Jashtë binte një shi me shtamba. Dhoma ku flinim ne, unë, mamaja dhe motra e vogël, Eglë katërvjeçare, ishte pa tavan. Dukej sikur rrebeshi i natës u binte me mijëra grushte tjegullave të mëdha. Që kur kishte ikur babai për në Kuçovë¹), mamaja flinte midis nesh. Të trokiturat kishin pushuar një copë herë. Era frynte me fërshëllimë të mprehta dhe mamaja në fillim nuk i kishte dëgjuar qartë. Të trokiturat ishin përsëritur disa herë dhe ajo më së fundi na e prishte gjumin. Më shpejt u zgjova unë. Eglë murmuriste dhe nuk donte t'i hapte sytë. Mamaja u ngrit nga rrobat dhe ndezi llambën me vajguri. Ndriçuan muret e bardha dhe patavrat e zeza të çatisë. Rrebeshi i shiut sikur nuk dëgjohej më edhe aq. Ne ndenjëm një copë herë të ulur ashtu mbi rrobat e shtruara në dysheme, me jorgan deri në mes. Të trokiturat e lehta u dëgjuan befas fare shkoqur. Eglë i hapi sytë menjëherë dhe u ngrit ndenjur. Ajo ishte atëherë e

1) Sot Qyteti «Stalin».

shëndetshme, me dy gërshta të shkurtër ngjyrë gruri. Sytë i kishte të mëdhenj, të kaltër. Sapo u dëgjuan të trokiturat, ajo u mbështet fort pas mamasë dhe i nguli sytë e mëdhenj.

«Tak... tak... trak...», u dëgjua përsëri e trokitura e zakonshme.

Fytyra e mamasë shprehu vendosmëri. U ngrit më këmbë, hodhi një rrobë të trashë supeve dhe doli. E ndoqa pas, ashtu zhveshur siç isha. Kaluam në dhomën tjetër, dritaret e së cilës binin nga rruga. Mamaja guxoi dhe hapi një kanat. Së bashku me zhurmën e stuhisë, depërtoi gjithë lagështia e natës.

— Kush është? — mezi mundi të fliste mamaja.

Asnjë përgjigje. Veç ulërimës së erës që frynte përjashta. Zgjata pak kokën të shikoja më mirë. Nuk dallohej asgjë. Pritëm disa çaste. Pastaj guxova të pyetja edhe unë:

— Kush je ti?

Mamaja buzëqeshi. Mbylli kanatin e dritares dhe shkuam përsëri në dhomën tjetër.

U shtrimë në dyshek, po gjumi nuk na zuri. Përveç Eglës. Ajo fjeti menjëherë dhe u zgjua vetëm të nesërmen në mëngjes. Mamaja më përkëdheli flokët, më afroi më shumë pas vetes dhe më puthi në ballë. Nuk e merrja dot me mend se për se mendonte atëherë. Sidoqoftë një farë ankthi të lehtë mundesha t'ia dalloja në sy. Ajo kishte sy si të Eglës, veçse akoma më të mëdhenj.

Të trokiturat u dëgjuan prapë aq befasisht, sa u ndodha më këmbë më parë se mamaja.

— Prit, — më tha ajo.

Hodhi rroben në krah dhe më kapi për dore. Qëndruam një çast në buzë të shkallëve të drunjta që

të zbritnin në katua. Pastaj hymë përsëri në dhomën tjetër. Ajo thirri këtë radhë pa e hapur dritaren:

— Kush troket aty? — Zëri i saj kësaj radhe ishte i ashpër. Unë u kapa fort pas dorës së saj dhe bëra po atë pyetje me zë të lartë.

Por edhe kësaj radhe nuk na u përgjigj njeri. Pritëm aty pranë dritares, një, dy, tri, pesë minuta. Lagështia e natës po më depërtonte në trupin e ngrohetë. Ajo më mbështolli më afër saj me njërin krah. Për herë të parë e kuptova qartë se unë isha e vëtmja mbështetje e saj atë natë. Era vazhdonte të fërshëllente më me tërbim. Vetëtiu fort. Pastaj gjëmoi. Gjëmimi, përkundrazi, më solli papritmas guximin. I thashë mamasë:

— Po zbres poshtë të hap derën!

— Po, xhan, — tha befas ajo, — do të zgresim. Vishu!

Vesha shpejt e shpejt xhaketën dhe dola. Ajo më priste në krye të shkallëve. Zbritëm poshtë. Në katua kishte shumë lagështirë. Currila uji vërshonin nëpërmjet të çarave të derës së madhe.

— Ka dalë gjoli, — tha befas mamaja.

Unë nuk e kuptova. Isha vetëm shtatë vjeç dhe gjolin e kisha parë të afrohej vetëm afër fshatit, po jo të na mbyste. Tani ne shtangëm para derës duke parë currilat e ujit. Ja, pikërisht atë çast trokitën përsëri. Në kohën që unë mendoja se mamaja do t'u ngjitej shkallëve përpjetë, ajo u afrua më pranë derës. Uji filloi t'i lagte këmbët, por ajo as që pyeti për të. Ma bëri me kokë t'i afrohesha. Pa më folur, më zgjati kandilin dhe tërroqi me gjithë forcën shullin e ndryshkur të derës. Dera u shty me rrëmbim dhe një dallgë e zezë uji u përplas pas këmbëve tona.

Era e fuqishme na fiku dritën. Befas, diçka e bardhë kapërceu pragun e derës dhe na u afrua, pastaj u shty në thellësi të katoit. Uji sa vente dhe shtohej dhe e gjithë kjo bëhej aq pa kuptuar, sa ne as që lëvizëm nga vendi.

Pritëm disa minuta. Nuk trokiti më njeri. Kur mezi mundëm ta ndiznim përsëri kandilin, pamë të habitur se në mes të katoit kishte qëndruar një pelikan gjigant. Ngriti kokën dhe na vështroi me frikë e mirënjohnje.

Gjithë atë natë nuk na shqetësoi më asgjë. Të nesërmen mamaja na tregoi se pelikani ishte i plagosur në njërin krah dhe dallga e kishte mbështetur pas derës sonë. Dhe kishte trokitur... trokitur... trokitur. Në mëngjes unë dhe Egla bërtitëm nga gjëzimi. Pelikani ishte aq i madh e krejt i bardhë, me gushë thuajse transparente, që i varej si trastë e zbrazur nën sqep. Egla u mat ta merrte në krahë, po kjo ishte thuajse e pamundur. Ai peshonte më shumë se vetë Egla. Njëherë hapi krahët e mëdhenj dhe u bë gati të fluturonte. U stepëm. Nuk kisha parë kurrë krahë aq të mëdhenj. Si mund të na ikte ashtu, fare parpitur? Na erdhi keq. Ishte një mysafir aq i këndshëm. E mbajtëm katër ditë në shtëpinë tonë. E ushqenim me cironj, që unë i kapja me një rrjetë-kosh buzë kanalit. Aty në kanal e lëshuam edhe pelikanin. Ai ndenji pak kohë duke notuar si barkë e vogël, zhyti dy-tri herë sqepin e madh në ujë, përplasi krahët dhe iku...

Kur erdhi babai, ne ia treguam atë ngjarje gjithë hare. Më pas ai na shpjegoi pse kishte ardhur pelikani si mysafir në shtëpinë tonë. Kënetën kishin nisiur ta thanin për ta bërë fushë pjellore dhe foletë e pelikanëve ishin prishur njëherë e përgjithmonë.

NA DUHET DRITË

Sapo isha shtrirë në dhomën time, kur aty rreth orës katër pasdreke trokitën me nxitimë në derë. Nuk kisha mundur të thosha as «Hyni», kur në derë u shfaq një njeri i veshur me rroba minatori, me flokë të pluhurosur, gjithë baltë në fytyrë; nën kominoshet e zeza i dallohej djersa e trupit. Në sytë e tij pasqyrohej një ndjenjë turpi, përzier me dëshpërim. Ai merrte frymë me vështirësi dhe i lëshoi krahët deri në dyshemë, drejtoi trupin përsëri dhe qëndroi para meje i dërrmuar.

— Galeria numër tre u shemb! — shqiptoi me zë të lartë dhe u mbështet përsëri pas derës.

Ungrita me vrull nga vendi dhe ndjeva një boshllék të çuditshëm të më ndrydhëte zemrën. Ishte si një nga ato thikat që shpesh i marrim kur nuk na qarkullon gjaku në rregull. Mendimin e parë që më lindi, ia thashë minatorit me zë të lartë:

— A ka të aksidentuar?

— Jo! — m'u përgjigj ai. — Jo, përfat të mirë!

Fytyra ime duhej të kishte pësuar atë çast një ndryshim të ndjeshëm, sepse pashë që nga buzët e minatorit doli një psherëtimë lehtësuese. Vështrova përtokë. Atë çast nuk doja të më thoshin asgjë tjetër. Kishte ndodhur një shembje. Kaq. Nuk kishte

viktima, nuk ishte dëmtuar njeri. Kaq. Asgjë tjetër nuk më interesonte atë çast, megjithëse vetë shembja ishte për ne një ngjarje e jashtëzakonshme. Kisha pesëmbëdhjetë vjet që punoja në gjeologji, dhe ky mund të ishte rasti i dytë. Ngrita kokën ta qetësoja dhe njeriun që rrinte para meje, po befas u hap dera dhe u dha në dhomë një burrë i shëndoshë, mosha e të cilit atë çast ishte e vështirë të përcaktohej, megjithëse unë e njihja më mirë se çdo njeri tjetër. Hodhi sytë mbi minatorin që rrinte kokulur para meje. Duart e tij të rreshkura, gjithë damarë mavi, e mbërthyen befas minatorin pas jakës së kominosheve dhe e mbështetën pas murit të dhomës.

— E shembët, hë? — pyeti ai me një nervozizëm të dukshëm. — E çmund të pritej tjetër prej jush?! Hajvan! — shau pastaj me forcë, duke pështyrë përtokë.

Ndërhyra midis tyre dhe e hoqa plakun mënjanë.

— Nuk ka viktima, — i thashë për ta qetësuar.

— Ka! — tha plaku me dëshpërim. — Gënjejnë, inxhinier, kur thonë se nuk ka viktima. Ka! — përsëriti me forcë. — Victimë është galeria ime. E paktë tē duket kjo??!

— Nuk ka kohë ta zgjatim, — thashë unë. — Po nisem. Eja, — i thashë minatorit që rrinte kokulur.

U vesha shpejt e shpejt. Plaku më vështronte më buzë tē shtrënguara. Pastaj hapi derën me rrëmbim dhe doli duke e përplasur pas vetes.

Unë dhe minatori i galerisë së shembur ecnim me nxitim. Plaku mezi na arriti. Ishte mbytur në djersë. Ai vinte i shkurtër, i shëndoshë dhe kokën e kishte tē thinjur. E ndjeva se midis nesh kishte

ndodhur një keqkuptim i madh dhe fajtor pér këtë isha tani vetëm unë. E dija pothuaj se ç'mendonte plaku. Ajo që ia kishte pasur frikën ai, kishte ndodhur aq papritmas pér mua, sa, pér dëshpërimin e të dyve, e ndieja se nuk isha në gjendje të ndryshoja më asgjë. Këtë ma tregonte qartë fytyra e tij. Dukej sikur kishte humbur në jetë diçka shumë të dashur. Rrudhat ishin thelluar papritur dhe sytë i kishim humbur shkëlqimiin. Të gjitha këto i vija re mirë. Doja të qetësoja me një farë mënyre atë dhe veten.

— Dëgjo, xha Shaban, — i thashë duke i hedhur dorën mbi sup, — ndoshta do ta eliminojmë shpejt. Ti e di më mirë se unë, po ngandonjëherë nëntoka ka edhe të papritura.

— Mos më ngushëllo! — rënkoj plaku. — Edhe ti, inxhinier, nuk je pa faj. Nuk dua të më shfajës sohesh. Mos më fol asgjë..., — shtoi kur vuri re se u bëra gati ta kundërshtoja. — Po fajin më të madh e kam unë.

Nuk i kundërshtoi njeri. Aq më pak minatori.

Rruga ishte e sheshtë, pastaj vinte një e tatëpjetë jo shumë e fortë. Që aty mund të dalloje qartë galerinë e hapur në shpatin tjetër të luginës...

...E gjithë kjo ishte një rrjedhje, kishte një hesap të vjetër që lidhej me mua dhe më plakun. Unë kisha vite që e njihja atë njeri dhe, megjithëse na kishte nderuar të gjithë me punën e tij, unë pér vete sepse kisha filluar dy-tre vjetët e fundit të humbisja besimin në forcat e tij. Të them të drejtën, edhe se si më vinte tek e shikoja të punonte nën tokë me shokë që s'ishin moshatarë të tij dhe kisha kohë që mendoja se duhej t'i gjenim një punë tjetër. Një herë që ia përmenda këtë, më pa thuajse me përbuzje dhe

u largua pa më kthyer asnje përgjigje. Kështu ishin shtyrë vitet. Ne kishim përfunduar së zbuluari disa vendburime, po plaku na ndiqte pas, kudo që shkoni. Me mua sikur nisi t'i këpuste një e nga një të gjitha lidhjet e dikurshme të miqësisë. Ai kishte thua jse frikë prej meje. Rronte me përshtypjen se mua më kishte kundërshtarim më të fortë. Unë, sipas tij, përpinqesha ta shkëputja nga galeria dhe ta caktoja di-ku gjetkë. Këtë kisha filluar ta kuptoja qartë dhe kisha hequr dorë pothuajse fare nga mendimi im. Tani kërkoja me çdo mjet ta afroja përsëri, të bëja shaka me të dhe të kujtoja ato. vite kur unë erdha të punoja në gjeologji pas bangave të fakultetit, ato vite kur unë isha aq i druajtur e ai aq i sigurt në vetvete. Një natë, në banakun e mensës, i thashë kamerieres t'i conte në tavolinë një raki. Kur ia shpunë gotën, ai pyeti se nga i vente. I buzëqesha së largu. Më pa një hop i menduar, pastaj ma bëri me dorë t'i afrohesha.

— Dëgjo, djalë, — tha, kur i vajta pranë. — Mora vesh që do të hapet galeria numër 3. Ma lër ta filloj unë atë punim.

I dhashë fjalën. Vetëm pas kësaj ai ngriti gotën e rakisë nga tavolina dhe e vuri në buzë.

Galeria numër 3 do të ishte punimi i fundit për të. Këtë llogari ai e kishte bërë aq mirë, sa ajo nuk i shkaktonte veçse dhembje. Së shpejti do të dilte në pension. Nuk mbante mend se sa galeri kishte hapur në jetë, por, në qoftë se para tridhjetë vjetësh ai, ndonëse djalë i ri, kërkonte të largohej nga puna nën tokë një orë e më parë, tani, aq plak dhe i pafuqishëm, as që i shkonte ndër mend një punë e tillë. Kur i thanë të hapte galerinë numër 3, vendosi që edhe këtë punim ta linte të pavdekshëm.

Galeria vinte e plotë, me të gjitha dimensionet e caktuara në pasaportë, e armatosur me shtylla të drejta li si të fortë. Ajo ishte një galeri thjesht për kërkime gjeologjike, megjithatë plaku nuk e nën-vleftësonë; ishte munduar të zhdukte nga të katër qoshet e galerisë dhe guriçkat më të vogla, duke i dhënë asaj formën e projektuar. Ditët kalonin njëra pas tjetrës. Befas nisi të kuptonte se galeria do të zgjaste më tepër sa pritej.

Aty nga fundi i majit kooperativa na dërgoi të punonte te ne një burrë të ri. Ishte shpatullgjerë, truplartë, me duar të mëdha, po pakëz i vrenjtur. Qemë interesuar qysh më parë për të dhe na thanë se në kooperativë punonte sa për dy. Vendosëm ta cakttonim në galerinë numër 3. Plakut ndoshta tanë do t'i lehtësohej puna. Natyrisht që këtë mendim nuk ia thamë atij. Disa ditë më vonë ai erdhi dhe e mburri punëtorin e ri.

— Dëgjo, inxhinier, — më tha, — ai djalë punon mirë. Vetëm që jo me ustallëk. Megjithatë do ta rregullojmë. Meqë vjen nga fshati...

Në tetor plakut i dhamë lejën e zakonshme dhe, kur u kthye, kishte vënë re se galeria nuk ishte më ajo e para. Edhe mua diçka kishte filluar të mos më pëlqente tek ai punim, por avancimi i lartë i minatorëve gjatë kohës kur mungoi plaku, sikur m'i kishte mbyllur sytë para cilësisë së punimit. Atë mbasdite plaku hyri në dhomën time dhe thuajse bërtiti...

— Ç'të bëj unë tanë, more inxhinier?! Ma kanë ngushtuar e shtrembëruar galerinë aq tepër, sa nuk mund të punohet më. Po si i keni lejuar të punojnë pa armatim, xhanëm?

Të them të drejtën, për herë të parë pas aq vjetësh nuk ia vura shumë veshin. Më dukej sikur plaku

në një farë mënyre na pengonte ritmin e avancimeve me punimet e tij të bukura. Kryesore për ne ishte t'i mbaronim punimet sa më parë. Punëtori i ri punonte shumë dhe mua kjo më kishte kënaqur.

Po atë mbasdite në mensë dëgjova të zhvillohej midis tyre kjo bisedë:

— Sa more pesëmbëdhjetëditheshin që shkoi? — e pyeti plaku burrin e ri.

— Gjashtëqind, — ishte përgjigjja.

Në zérin e tij, megjithëse larg, unë ndjeva një lloj mburrjeje.

— Haram i paç! — mallëkoi befas plaku. — Tani e kuptova përse galeria ishte katandisur në këtë gjendje. Haram! Dëgjon... na turpërove, lanet, pér hiçgjë...

Që të nesërmen ai iu përvesh punës. Ndërsa më i riu avanconte përpara nën mbikëqyrjen e rreptë të tij, ai mëremetonte nga pas shtrembërimet. Kjo punë i hëngri më se një javë. Hyja dhe dilja thuajse çdo ditë në atë galeri dhe e vija re mirë se si ndryshonte. Pas dhjetë ditësh balli priti përsëri trapezin e dritës që buronte nga hyrja.

Një muaj më vonë ata u grindën keq me njërit-tjetrin. Me sa mora vesh, puna ishte përrugën e shinave. Plaku e kishte marrë vetë në dorë avancimin e galerisë, ndërsa më të riut i kishte lënë të pregatiste kasat e armaturave, të shtronte shinat dhe të shtynte vagonat me steril. Atë ditë plaku mëremetonte dy kasa të shtrembra, ndërsa ndihmësi i tij po hiqte nga balli sterilin. Diku plaku ndjeu se vagoni doli nga shinat dhe u anua në një krah. Djali ishte munduar ta rregullonte këtë gjendje ashtu, shpejt e shpejt, po vagoni ishte shumë i rëndë dhe ai as që mundi ta lëvizte nga vendi. I foli plakut. Xha Shabanit nguli njérën majë të sqeparit pas shtyllës dhe,

duke fshirë djersët me kurrizin e dorës, iu afroa vagonit.

— Të ra, hë? — e pyeti pa e parë drejt në sy. Dhe, pa marrë përgjigje, e urdhëroi: — Shko më sill një shtyllë të hollë. Shpejt!

Burri u kthye pas disa minutash. Plaku i mori shtyllën nga duart dhe e futi nën vagon. Njërin cep të saj e ngjeshi fort pas shinës dhe mbështeti supin pas cepit tjetër. Vagoni lëvizi çuditërisht lehtë nga vendi dhe, kur burri priste të vendosej shina, ngjau diçka tjetër. Nga forca e plakut shina lëvizi nga vendi dhe u kthye nga ana e saj e gjerë. Vagoni u lëkund rëndë dhe gati sa nuk u përmbysh. Ata u larguan dy-tre metra. Kur e pa se q'ndodhi, plaku e mbërtheu më të riun pas jakës së peliqes dhe e shkundi fort.

— Edhe këtu ma hodhe, hë! — bërtiti befas me sa kishte në kokë.

Djali u përgjigj se nuk ishte faji i tij, në qoftë se ishte shtrembëruar shina. Ai për vete e kishte bërë punën. Plaku nuk i la gjë pa thënë. I përmendi ditët e punës në kooperativë, të cilat i kishte marrë me siguri kështu, duke gënjerë të tjerët dhe se, në qoftë se atje u kishte hedhur hi syve njerëzve, këtu nuk e lejonte askush. Këtë burri nuk e kishte gjelltitur. Kishte hedhur peliqen në sup dhe ishte larguar nga galeria. Po atë mbasdite erdhi të ankohej tek unë. E dëgjova me vemendje. Sipas tij, xha Shabani nuk ishte gjë tjetër, veçse një plak grindavec që, për të mbuluar mungesën e fuqisë për punë, merrej gjithë ditën në galeri me zbulimë. Nuk kisha arritur t'i jepja përgjigje shpjegimit të tij, kur hyri plaku.

— E di se ç'të ka thënë! — m'u drejtua ai menjëherë mua.

— E di, e shava paq! Unë mendoj se ai nuk është për në galeri. Le të vejë të punojë gjetkë.

Këto fjalë më tingëlluan keq. Nuk do të kisha dashur që plaku të arrinte në një konkluzion të tillë. I thashë:

— Ajo që thua ti, nuk bëhet. E kemi një nga punëtorët më të mirë. E di se sa metra na dha pesëmbëdhjetëdëshin e kaluar?

— Nuk kemi nevojë vetëm për metra, — tha plaku, duke më kundërshtuar haptazi. — Në qoftë se ty të duhen vetëm metra dhe jo galeri për të qenë, atëherë eja me mua të të dëftoj ca tunele urithësh dhe raportoja drejtorit si galeri... Unë e di mirë se ç'them. Këtë e njoh më mirë se ti.

E kisha shumë të vështirë të bindesha me fjalët e tij. Megjithatë unë ngula këmbë që i riu të mos largohej nga galeria.

Tri ditë me radhë ata nuk kishin folur me njëri-tjetrin. Kjo gjendje nuk mund të vazhdonte kështu. E mendova aq shumë këtë problem, sa vendosa që njëri prej tyre duhej të largohej nga kjo galeri. Ky arsyetim më çoi në mendimin e vjetër se xha Shabani ishte tepër plak për punën në galeri dhe se i duhej gjetur një punë tjetër. E thirra një mbasdite në zyrë dhe i thashë me shumë takt:

— Kam një problem të vështirë dhe dua të më ndihmosh. Shpesh plasjet e minave në galeri nuk na japin rendimentin e duhur. Mendoj se ka shumë shkaqe... — dhe nisa t'i tre goja të gjitha ç'dija për dobësitë e mbushjes së birave.

— Bjeri shkurt, — më ndërpren befasi.

— Dua të kalosh si zjarrmëtar, — i thashë.

Plaku u vrenjt në fytyrë nga inati. U nxitova

të shtoja diçka tjetër, por ai luajti dorën e ashpër drejt meje dhe tha:

— E di... këtë e pritja prej kohësh. Derisa thua ti, do ta bëj. Por, ma ke më hile, o inxhinier!

Si tha këto, hapi derën dhe iku. Ndjeva një boshllék të çuditshém. Nuk më kishte vajtur mendja se ai do të ndahej nga puna e tij e dashur në këtë mënyrë. C'ishte ky dëshpërim, xhanëm? — nisa të arsyetoja unë. Të ishte vallë marazi për galerinë numër 3 që nuk mundi ta mbaronte ashtu siç dëshironte vetë? Tridhjetë vjet me radhë ai kishte hapur galeri e puse nga më të ndryshmet. Ishte zvaritur llavave të qymyrit, kishte thithur erën e lagështirës, të karbitit, të dinamitit. Megjithatë ngrohtësinë që buronte nga nëntoka, sidomos në ditët kur në male acari të merrte fryshtë, ai nuk mund ta zëvendësonte me asgjë. E vërteta është, arsyetoja unë, se ai do të kishte përsëri punë me nëntokën, po ndryshe është të jesh luftëtar në ballë e ndryshe të marrësh pjesë si i huaj në gjëzimin e fitores...

...Dhe ja, tani kishte ndodhur pikërisht ajo që ai e kishte parashikuar me kohë. Vetë shembjes i shtohej tani edhe zhënjimi im më i madh në lidhje me xha Shabanin. E ndieja veten fajtor para këtij njeriu. E shikoja se si ecte me vrapi pas nesh, i mbetur në djersë, me sytë drejtuar nga galeria. Një tjetër, mendova atë çast, ndoshta nuk do të pranonte as të vinte.

Arritëm në galeri të mbetur në djersë. Burri qëndronte në prag të nëntokës, me duar të kryqëzuara, duke vështruar flakëzën e vogël të llambës me karbit që e kishte lëshuar aty para vetes. Siç mësuam, shembja kishte ndodhur papritur e pakujtuar. Në fillim kishin rënë disa guriçka. Pastaj ndonjë gjysmë

vagon shkëmb i thërrmuar. Ai bashkë me shokun ishin larguar të preqatitnin armaturën... Nuk kishin bërë as disa metra kur një oshëtimë e fortë përplasi ajrin e lagur pas faqeve të paarmatosura të galerisë dhe shkëmbi kishte mbushur hapësirën. Ata kishin vrapuar të dilnin.

Burri as që m'i hodhi sytë fare. Vetëm kur plaku u shfaq pas kurrit tim, ai u ngrit më këmbë. Plaku qëndroi para tij duke dihatur fort, sepse e përpjeta e kishte lodhur. I ngriti kokën lehtë më të riut dhe, për habinë time, e pashë se sytë iu mbushën me zjarr.

— Keq, — tha plaku, — po do ta rregullojmë.

Vuri në kokë kapelën e minatorit dhe, pasi i dha ujë llambës së karbitit, hyri në galeri. Flakëza dre-dharake erdh e u drejtua e pas pak shkëlqimi i saj nisi të zgjonte errësirën. Ne të tjerët ecnim pas tij dhe vinim re se si copëtohej prej trupit të tij një lloj mjegulle e lehtë që kishte mbushur gjysmën e galerisë. Era e lagështirës më shponte hundët. Pas pak shenjat e shembjes nisen të dukeshin kudo.

Pesë metra larg vendit të shembur qëndruam. Plaku u kthyte prapa dhe mati diçka me hapa. Kur u kthyte, iu drejtua më të riut:

— E shikon sa shumë ke avancuar, pa armatim? Edhe sikur ç'të ishte, do të shembej. Tani ke punë sa për dy javë. Fluturuan paratë! — përfundoi me ironi, duke më hedhur edhe mua një vështrim të rreptë.

Shembja më dukej me të vërtetë shumë e madhe. Kisha lejuar të avancohej pa u armatosur dhe... E kuptova gjithë vështrimin e plakut. Minatori i ri kishte punuar jo aq për plan, sesa për para...

— C'duhet të bëjmë? — i thashë plakut.

— Kjo do tē rregullohet, — m'u përgjigj. —
Është e keqja më e vogël. Unë po mendoj diçka tjetër. Si duhet tē meremetoj mendjen e shokut tim. Kjo është më e rëndësishmja.

Më vështroi përsëri në sy. Ngurroi një çast, siç m'u duk, dhe pastaj tha:

— Para se tē fillojmë, dua diçka prej teje, o inxhinier!

— Fol...

— Më lejo tē punoj edhe këto kohë që më kanë mbetur në galerinë time. Mbase do tē gjesh ndonjë zjarrmëtar tē zot.

U mendova. Ndërkohë ai u vu tē dridhte një cigare. Sa shumë duhet tē mësoj nga ky njeri, mendova. Plaku më zgjati kutinë. Atë çast u shkëput nga tavani një gur i vogël dhe ra afër këmbëve tē mia. U zmbrapsa ndonjë metër.

— Mos u tremb, — më tha plaku, — tani nuk do tē shembet më.

Pimë cigaret.

— Epo..., — filloi plaku duke ngritur duart, — tē na vejë mbarë!

Unë pohova me kokë. Burri i ri se nga ishte zhdukur, po pas pak erdhi me një llambë tjetër karbiti në dorë.

— E filluam mbarë! — shqiptoi plaku me zë tē lartë. — Kryesorja është drita. Të shohim qartë se ç'jemi duke bërë e ç'duhet tē bëjmë.

Unë qesha.

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Njeriu me shark	3
Kur më erdhi radha të flitja	14
Demiri	28
Banorët e qytetit që do të ngrihet	41
Jeta në kënetë	53
Shqetësim	66
Jeta mbi shkëmbinj	81
Mysafiri i natës	93
Na duhet dritë	97